

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5934  
E martë, 19 nëntor 2019  
çmimi 0.40 €

## Prokuroria Speciale kritikohet për mostrajtim të rasteve të korrupsionit

FAQE 8-9



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com

Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", ALBINOT MALOKU | FAQE 4-5



## VONESA PËR KRIJIMIN E INSTITUCIONEVE NUK I KONTRIBUON MOMENTUMIT NË TË CILIN NDODHET KOSOVA

Njohësi i proceseve politike në vend, Albinot Maloku, ka thënë se vonesa për krijimin e institucioneve të reja nuk i kontribuon momentumit në të cilin ndodhet Kosova. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se përgjegjshmërinë e qytetarit të treguar më 6 tetor janë duke e nëpërkëmbur të gjithë aktorët pjesëmarrës,

me situatën e krijuar, në këtë fazë të rinumërimit të votave. Duke folur për ecurinë e diskutimeve në mes të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës, Maloku ka pohuar se nuk sheh hezitim real nga ana e LDK-së për të mos qeverisur me LV-në si parti fituese e zgjedhjeve. Ai ka theksuar se tradita që në pazaret politike të hyjë

edhe pozita e presidentit duhet të marrë fund njëherë e mirë. Sipas Malokut, vendi ka president dhe kjo çështje nuk do të duhej të bëhej çështje për diskutim. Në këtë intervistë Maloku ka thënë se nga ky proces zgjedhor doli edhe një opozitë e re, e cila, sipas tij, mund të jetë faktori më stabilizues i rrjedhave politike të cilat e presin Kosovën

### OPINION

#### GJYKATA SPECIALE, INKUIZICIONI MODERN DHE DHUNIMI I KUJTESËS!

Behxhet Sh.  
SHALA - BAJGORA

F. 10-11



### AKTUALE



#### KRYEZIU: RINUMËRIMI I VOTAVE DO TA GARANTOJË LEGJITIMITETIN E PROCESIT ZGJEDHOR

F. 3

#### MYFTIU TËRNAVA SHKON PËR VIZITË ZYRTARE NË ARABINË SAUDITE

F. 7

### EKONOMI

#### FILLON 'JAVA GLOBALE E NDËRMARRËSISË', MARRIN PJESË RRETH 60 BIZNESE TË REJA

F. 8

#### NË MUNIH U MBAJT SESIONI INFORMUES 'KLIMA E INVESTIMEVE NË KOSOVË'

F. 8

### SPORT

#### ELIMINATORET TË SUKSESSHME, KUALIFIKIMI NË MARS

F. 20



**Mustafa  
njofton  
Kosnetin për  
ecurinë e  
diskutimeve  
me LV-në për  
formimin e  
qeverisë**

FAQE 5



NË TIRANË ËSHTË MBAJTUR KONFERENCA NDËRKOMBËTARE  
"FEJA SI NJË INSTRUMENT PËR PAQEN"

FAQE 3

## Kosova dhe Shqipëria zotohen për luftimin e ekstremizmit dhe terrorizmit

Kosova dhe Shqipëria janë zotuar për vazhdimin e luftimit të ekstremizmit dhe terrorizmit. Në konferencën ndërkombëtare "Feja si një instrument për paqen", e cila është mbajtur në Tiranë, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dhe ai i Shqipërisë, Ilir Meta, kanë bërë me dije se shoqëritë e rajonit ndaj çdo forme të fundamentalizmit apo terrorizmit ideologjik mund të përballen vetëm si të bashkuara. Në këtë konferencë është vlerësuar lart toleranca fetare ndër shqiptarë



**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Tahiri: Kosova ka shënuar progres substancial në sundimin e ligjit

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka marrë pjesë në Forumin për çështjet e drejtësisë dhe punëve të brendshme mes Bashkimit Evropian dhe shteteve të Ballkanit Perëndimor, i cili po zhvillohet në kuadër të kryesimit finlandez me Këshillin e BE-së. Gjatë këtij forumi i cili po mbahet në Shkup të Maqedonisë së Veriut, ministri Tahiri ka thënë se në komponentin institucional të drejtësisë, Republika e Kosovës gjatë dy viteve të fundit ka bërë

një legjislacion të ri dhe domethënë, që synon ta bëjë drejtësinë të qasshme dhe të drejtë për qytetarët e Kosovës, si dhe efikase e të zbatueshme për institucionet e drejtësisë. Duke folur për sistemin e drejtësisë në Kosovë, ministri Tahiri përmendi të arriturat në sektorin e sundimit të ligjit siç janë miratimi i Kodit të ri Penal, pakon e ligjeve të gjyqësorit, Ligjin e ri për konfiskimin e aseteve të paligjshme dhe pakon e ligjeve për të drejtat pronësore.

Para homologëve të tij të shteteve të rajonit dhe zyrtarëve të lartë të BE-së, ministri Tahiri tha se Ministria e Drejtësisë ka filluar dhe është në proces të përfundimit të rishikimit funksional të Sektorit të sundimit të ligjit, që sipas tij është reforma kyçe që do të arrijë një Strategji Kombëtare për Sektorin e sundimit të ligjit. Ministri Tahiri tha se të gjitha këto reforma janë pjesë e përbushjes së obligimeve që rrjedhin nga MSA-ja.



## Engeli: Ndryshimi i kufijve nuk do të ndalej me Kosovën

Kongresisti amerikan Eliot Engel është skeptik për idenë e ndryshimit të kufijve, pasi nuk do të ndalej me Kosovën pasi kjo do të shkaktoje një reagim zinxhir dhe nuk do të ishte pozitive

WASHINGTON, 18 NËNTOR - Kongresisti amerikan Eliot Engel paralajmëron kundër idesë së ndryshimit të kufijve mes Kosovës dhe Serbisë. Kryetari i Komisionit të Dhomës së Përfaqësuesve për Marrëdhëniet me Jashtë tha, se shpreson që Qeveria e ardhshme e Kosovës të ketë një bazë sa më të gjerë dhe se do të bëjë të pamundurën për të ndihmuar Kosovën dhe Shqipërinë. Engeli thotë se është skeptik për idenë e ndryshimit të kufijve, pasi nuk do të ndalej me Kosovën. "Kjo do të shkaktoje një reagim zinxhir që unë mendoj se nuk do të ishte pozitiv. Ne i dimë parametrat për Kosovën. Unë mendoj se ndryshimi i kufijve do të ishte një

ide e gabuar. Mendoj se kjo nuk do të ishte një gjë e mençur", i tha ai "Zërit të Amerikës". Engeli tha se shpreson që Qeveria e Kosovës të ketë një bazë sa më të gjerë, në mënyrë që të ketë më shumë njerëz të përfshirë në koalicion për trajtimin e sfidave, pasi vendi përballlet me disa probleme. "Serbia po bën përpjekje të forta për të deligitimuar Kosovën. Ajo po përpiqet t'i bindë vendet që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës që t'i tërheqin njohjet. Ne po luftojmë kundër këtyre përpjekjeve. Kështu që sa më i bashkuar të jetë vendi aq më mirë do të jetë për vendin", tha ai. Kongresisti nga Nju Jorku, nuk pranoi të komentonte lidhur me



kryetarin e Vetëvendosjes, Albin Kurti, pasi tha se nuk komenton për kandidatët për kryeministër në vende të tjera. "Por më lejoni të them se kam besim se Shtetet e Bashkuara, me nxitjen time si kryetar i Komisionit për Marrëdhëniet me Jashtë, do të vazhdojnë të kenë marrëdhënie të ngushta me kombin shqiptar, me popullin shqiptar dhe me njerëzit në Kosovë. Dhe sigurisht që unë

jam i gatshëm të ndihmoj në çfarëdo mënyre që mundem, kështu që kushdo që zgjidhet, Kurti apo dikush tjetër, unë do të ofroj ndihmën time", tha ai. Duke folur për presidentin serb, Aleksandër Vuçiq, ai solli si shembull rastin e vëllezërve Bytyçi, për premtimet që ai ka bërë dhe nuk i ka mbajtur, duke thënë se nuk ka bërë asgjë në këtë drejtim. Engeli nuk iu përgjigj direkt një

pyetjeje për rolin e të dërguarve të posaçëm për Ballkanin dhe bisedimet Kosovë-Serbi, Matthew Palmer dhe Richard Grenell, por tha se në çdo dialog që ka të bëjë me të ardhmen e Kosovës, duhet të ketë zë populli i Kosovës. "Të gjitha këto gjëra të tjera që po përpiqen të bëjnë me Shqipërinë, Serbinë, nëse nuk përfshihet Kosova, nuk do të jetë një vendim i drejtë. Kështu që mendoj se duhet të merret vendimi i popullit të Kosovës për gjithçka", tha ai. Dhe sipas tij, Shtetet e Bashkuara duhet të marrin një rol më aktiv. "Si kryetar i Komisionit të Marrëdhënieve me Jashtë, si mbështetës i fortë i Kosovës dhe Shqipërisë unë do të bëj gjithçka që mundem për ta realizuar këtë dhe për çfarëdo të kenë nevojë zyrtarët e zgjedhur të Kosovës dhe Shqipërisë, unë gjithmonë jam i gatshëm të ndihmoj", tha kongresisti amerikan.

## Meta: Ambasadori i OSBE-së nuk është i mirëpritur në Presidencë

TIANË, 18 NËNTOR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta njoftoi të hënën se ambasadori i OSBE-së në Tiranë Bernd Borschardt nuk është më i mirëpritur në Institutin e Presidentit të Republikës. Këtë vendim kabineti i Metës ia ka bërë të ditur përmes një letre zyrtare, Asamblesë Parlamentare të OSBE-së,

Pranisë së kësaj organizate në Tiranë si dhe Protokollit të Shtetit. Shkak, sipas letrës, është se ambasadori Borschardt "vuri në diskutim dekretin e presidentit për zgjedhjet vendore në Shqipëri të muajit qershor". Ndërsa kishte caktuar fillimisht mbajtjen e zgjedhjeve më 30 qershor, në fillim të po këtij muaji, në momente të një ten-



sioni të fortë politik, Meta anuloi datën, për të firmosur më vonë, një datë të re, 13 tetorin.

Dekreti i tij nuk u mor në konsideratë dhe zgjedhjet u zhvilluan më 30 qershor, nën monitorimin si të vëzhguesve të ODIHR-it ashtu dhe të përfaqësive të ndryshme diplomatike në Tiranë. Një tjetër arsye për vendimin e marrë nga presidenti Meta, është dhe incidenti që ambasadori Borschardt pati një

muaj më parë kur befasi u gjet në mesin e thirrjeve "Rama ik" dhe "Shame on you" në rrugën pranë drejtorisë së Policisë së kryeqytetit, ku familjarët e disa të arrestuarve po protestonin për lirin e njerëzve të tyre. Ai u kundërpërgjigj duke ngritur gishtin e mesit të njëjës dorë, gjest për të cilin ai kërkoi ndjesë publike 24 orë më vonë.

## Hungarezi Oliver Varhelyi zgjidhet komisionar i Zgjerimit të BE-së

STRASBURG, 18 NËNTOR - Parlamenti Evropian e miratoi Oliver Varhelyin për komisionar të Zgjerimit të Bashkimit Evropian. Varhelyi, kandidat nga Hungaria, ka qenë në seancë dëgjimore javën e kaluar, por nuk ka arritur t'i bindë plotë-

sisht ligjvënësit e Parlamentit Evropian se është i gatshëm për postin. Atij i është dashur të përgjigjet edhe në pyetje shtesë me shkrim. Përgjigjet janë dërguar paraditen e së hënës dhe kanë qenë të mjaftueshme që deputetët të

konfirmojnë emërimin e tij, ka njoftuar rfe. Varhelyi është kandidati i dytë nga Hungaria për komisionar evropian. Para tij ka qenë Laszlo Troscanyi, i cili është refuzuar nga Parlamenti Evropian për shkak të konflikteve të interesit.

Në total, Parlamenti Evropian ka refuzuar tre kandidatë nga Hungaria, Rumania dhe Franca. Kjo ka qenë edhe arsyeja përse përbërja e re e Komisionit Evropian nuk e ka nisur punën më 1 nëntor, ashtu siç ka qenë e planifikuar fillimisht.



Në Tiranë është mbajtur konferenca ndërkombëtare "Feja si një instrument për paqen"

# Kosova dhe Shqipëria zotohen për luftimin e ekstremizmit dhe terrorizmit



Kosova dhe Shqipëria janë zotuar për vazhdimin e luftimit të ekstremizmit dhe terrorizmit. Në konferencën ndërkombëtare "Feja si një instrument për paqen", e cila është mbajtur në Tiranë, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dhe ai i Shqipërisë, Ilir Meta, kanë bërë me dije se shoqëritë e rajonit ndaj çdo forme të fundamentalizmit apo terrorizmit ideologjik mund të përballen vetëm si të bashkuara. Në këtë konferencë është vlerësuar lart toleranca fetare ndër shqiptarë

**EPOKA ERE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 18 NËNTOR** - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dhe ai i Shqipërisë, Ilir Meta, janë zotuar për vazhdimin e luftimit të ekstremizmit dhe terrorizmit si dhe për kthimin e qytetarëve të të dyja vendeve nga kampet e luftës në Siri. Në konferencën ndërkombëtare "Feja si një instrument për paqen", të organizuar në Tiranë, të dy presidentët kanë deklaruar se ndaj çdo forme fundamentalizmi, ekstremizmi apo terrorizmi ideologjik mund të përballlemi vetëm po të jemi të bashkuar. Presidenti Hashim Thaçi ka treguar se Kosova është përballur me sfidën e elementeve të ekstremizmit dhe radikalizmit, por ka reaguar menjëherë dhe me

vendosmëri. "Kemi ndërtuar legjislacionin që ndalon jo vetëm përhapjen e urrejtjes fetare, por edhe pjesëmarrjen në luftërat jashtë Kosovës. Janë marrë masa kundër atyre që kanë nxitur urrejtje, por edhe që kanë marrë pjesë në luftërat e huaja. Institucionet e Kosovës tani janë duke punuar me ata që kanë shkuar në këto luftëra, por janë penduar dhe kanë kërkuar të kthehen. Së bashku me komunitetin fetar po punojmë për kthimin dhe risocializimin e të kthyerve", ka deklaruar Thaçi.

Më tej, ai ka folur për përvojën e Kosovës me fenë dhe paqen, duke përmendur disa të arritura në këtë drejtim. "E arritura e parë është që nuk kemi lejuar që në luftën e Kosovës për liri e pavarësi të implikohet feja. Pra, Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk ka lejuar

asnjë ideologji fetare të bëhet pjesë e luftës së saj. Kështu kemi vazhduar traditën e Kosovës, ku asnjëherë nuk kemi pasur konflikt ndërfetar. Madje gjatë viteve të luftës Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk ka lejuar që të preket asnjë objekt fetar apo i kultit, i cilitdo religjion që të ketë qenë. E dyta, Kosova ka përfshirë fenë, liderët fetarë, në përpjekjet për të ndërtuar paqe e mirëkuptim në mes njerëzve, që nga përfundimi i luftës", ka treguar presidenti Thaçi.

Ai ka vlerësuar se të arriturat e Kosovës në këtë drejtim njihen ndërkombëtarisht. "Ndiem shumë krenar që administrata e ShBA-së e ka vlerësuar Kosovën si kampione rajonale në luftën kundër ekstremizmit dhe terrorizmit. Kosova do të vazhdojë të jetë pjesë aktive dhe dinamike e

koalicionit kundër ekstremizmit dhe terrorizmit. Së bashku me komunitetin fetar dhe miqtë ndërkombëtarë po punojmë për risocializimin e të kthyerve nga luftërat e huaja. E dimë se është proces shumë i ndjeshëm, por jemi duke punuar kujdesshëm dhe me vendosmëri", ka thënë Thaçi.

Edhe presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka treguar për sfidat me të cilat është përballur shoqëria shqiptare në këtë fushë. Ai ka thënë se liria fetare është thelbësore për paqen dhe stabilitetin në shoqëritë demokratike. Sipas Metës, vetëm të bashkuara shoqëritë e rajonit mund të përballen me fenomenin e ekstremizmit dhe terrorizmit. "E konsideroj veten të privilegjuar që jemi mbledhur sot në kryeqytetin e vendit tonë për një çështje kaq

fisnike dhe të rëndësishme për të gjithë, për fëmijët tanë dhe për të ardhmen tonë. Ndaj çdo forme fundamentalizmi, ekstremizmi, terrorizmi ideologjik apo dogmatik mund të përballlemi vetëm duke qenë të bashkuar. Të bashkuar rreth vlerave universale dhe njerëzore që i shërbejnë paqes dhe prosperitetit për qytetarët dhe vendet tona", ka thënë Meta.

Në adresimin e tij, presidenti shqiptar ka përmendur edhe çështjen e kthimit të personave që kanë shkuar për të luftuar në Siri. Sipas tij, duhen ngritur urgjentisht qendra të rehabilitimit për t'u siguruar se persona të tillë të integrohen në shoqëri dhe të rehabilitohen nga traumat. "Të gjitha vendet e rajonit i janë bashkuar koalicionit global kundër terrorizmit, por ne duhet të sigurojmë stabilitet politik për secilin vend dhe rajonin tonë në mënyrë që t'u krijojmë siguri popujve tanë dhe ta arrijmë zhvillimin e ekonomive dhe të mos lejojmë shfaqjen e çdo ekstremizmi fetar, diplomacinë e butë nga faktorë të tretë dhe ndikimin e huaj negativ", ka deklaruar Meta. Në këtë konferencë ka folur edhe Sam Brownback, ambasador i Shteteve të Bashkuara për liri fetare ndërkombëtare. "Në shumë vende të botës feja është përdorur si instrument jo i paqes, por i konfliktit. Vendet që përqafojnë lirinë fetare do t'i marrin përfitimet e prosperitetit, paqes, një ekonomie të lulëzuar, më pak terrorizëm më pak dhunë", ka deklaruar Brownback. Ai e ka vlerësuar lart Shqipërinë për shembullin e tolerancës ndërfetare.

Në konferencën "Feja si një instrument për paqen", të organizuar nga presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, në bashkërendim me Departamentin e Shtetit të ShBA-së, kanë marrë pjesë edhe kryetari i Parlamentit të Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi, kryetari i Parlamentit të Malit të Zi, Ivan Brajović, si dhe kërret e bashkësive fetare në Shqipëri, Kosovë, Bosnje dhe Hercegovinë dhe vende të tjera të rajonit.

## Kryeziu: Rinumërimi i votave do ta garantojë legjitimitetin e procesit zgjedhor



**PRISHTINË, 18 NËNTOR (ER)** - Drejtori i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka thënë se, pavarësisht prej vonesave për certifikimin e rezultateve zgjedhore, rinumërimi do ta garantojë legjitimitetin e procesit zgjed-

hor dhe do t'i shmangë të gjitha dyshimet për manipulim ose deformim të vullnetit qytetar nga ana e komisionarëve. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se rinumërimi nuk pritet t'i ndryshojë rezultatet zgjedhore

e as renditjen e subjekteve politike. "I vetmi subjekt që mund t'i nënshtrohet ndryshimit në rezultatet zgjedhore është koalicioni Nisma-AKR-PD, i cili ka rezultat shumë të ngushtë, me vetëm 21 vota sa ishte mbi pragun 5 për qind. Numri kaq i

vogël prej 21 votave, të cilat e bëjnë dallimin e kalimit të pragut ose mbetjes nën prag, potencialisht mund të ndikojë edhe nga gabimi më i vogël gjatë procesit të numërimit e i cili ka mundur të ndodhë më 6 tetor", ka shkruar Kryeziu.

Flet për "Epokën e re", Albinot Maloku

# Vonesa për krijimin e institucioneve nuk i kont



Njohësi i proceseve politike në vend, Albinot Maloku, ka thënë se vonesa për krijimin e institucioneve të reja nuk i kontribuon momentumit në të cilin ndodhet Kosova. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se përgjegjshmërinë e qytetarit të treguar më 6 tetor janë duke e nëpërkëmbur të gjithë aktorët pjesëmarrës, me situatën e krijuar, në këtë fazë të rinumërimit të votave. Duke folur për ecurinë e diskutimeve në mes të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës, Maloku ka pohuar se nuk sheh hezitim real nga ana e LDK-së për të mos qeverisur me LV-në si parti fituese e zgjedhjeve. Ai ka theksuar se tradita që në pazaret politike të hyjë edhe pozita e presidentit duhet të marrë fund njëherë e mirë. Sipas Malokut, vendi ka president dhe kjo çështje nuk do të duhej të bëhej çështje për diskutim. Në këtë intervistë Maloku ka thënë se nga ky proces zgjedhor doli edhe një opozitë e re, e cila, sipas tij, mund të jetë faktori më stabilizues i rrjedhave politike të cilat e presin Kosovën

juar, në këtë fazë të rinumërimit të votave. Duke folur për ecurinë e diskutimeve në mes të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës, Maloku ka pohuar se është e kuptueshme që këto dy subjekte kanë dallime, madje politike dhe ideologjike, mirëpo thotë se nuk sheh hezitim real nga ana e LDK-së për të mos qeverisur me vendin së bashku me fituesin e zgjedhjeve. Ai ka theksuar se tradita që në pazaret politike të hyjë edhe pozita e presidentit duhet të marrë fund njëherë e mirë. Sipas Malokut, vendi ka president dhe kjo çështje nuk do të duhej të bëhej çështje në diskutim. Në këtë intervistë Maloku ka thënë se nga ky proces zgjedhor doli edhe një opozitë e re, e cila, sipas tij, mund të jetë faktori më stabilizues i rrjedhave politike të cilat e presin Kosovën.

**"Epoka e re":** Z. Maloku, Kosova ende nuk e ka përmbyllur procesin zgjedhor, pos asaj që dimë, radhitjen e partive në këto zgjedhje. Si i vlerësoni ju zgjedhjet e 6 tetorit dhe vonesat

që po ndodhin pas kësaj date?

**Maloku:** Këto zgjedhje mund të cilësohen më të mirat e organizuara deri më tani. Kultura politike që treguan qytetarët, si gjatë fushatës, po ashtu edhe në ditën e zgjedhjeve, ishte në nivel të lartë, madje për t'u marrë shembull nga qytetarët e të gjitha vendeve të Ballkanit. Zgjedhjet e 6 tetorit sikur rikthyen besimin te vota dhe mundësia e ndryshimit përmes saj. Por hije aspak të mirë këtij procesi po i bën tejzgjatja, përkatësisht katrahura e krijuar me numërimin e votave. Praktikant me të cilat po funksionon Këshilli Qendror i Zgjedhjeve po dalin jo të mira dhe assesi efikase. Vonesat për përmbylljen e këtij procesi dhe zgjedhjet e organeve të reja drejtuese të shtetit, pra të Kuvendit e Qeverisë, aspak nuk i kontribuojnë momentumit në të cilin ndodhet Kosova. E këtë fazë transitore, përmes një angazhimi maksimal, është duke e shfrytëzuar Serbia kundër vendit tonë. Po e theksoj: përgjegjshmërinë e qytetarit të treguar më 6 tetor janë duke e përbuzur e nëpërkëmbur

**EPOKA E RE****Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 18 NËNTOR** - Njohësi i proceseve politike në vend, Albinot Maloku, zgjedhjet e 6 tetorit i ka cilësuar më të mirat e organizuara deri më tani. Ai ka thënë se kultura politike që treguan qytetarët, si gjatë

fushatës, po ashtu edhe në ditën e zgjedhjeve, ishte në nivel të lartë, madje për t'u marrë shembull nga qytetarët e të gjitha vendeve të Ballkanit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Maloku ka theksuar se hije aspak të mirë këtij procesi po i bën tejzgjatja. "Vonesat për përmbylljen e këtij procesi dhe zgjedhjet e organeve

të reja drejtuese të shtetit, pra të Kuvendit e Qeverisë, aspak nuk i kontribuojnë momentumit në të cilin ndodhet Kosova", ka thënë ai.

Maloku ka shtuar se përgjegjshmërinë e qytetarit të treguar më 6 tetor janë duke e përbuzur e nëpërkëmbur të gjithë aktorët pjesëmarrës, me situatën e kri-

# ribuon momentumit në të cilin ndodhet Kosova



nisur nga premisat kushtetuese për sa i përket të drejtës së subjekteve politike për të qeverisur. Pra, LV-ja e para, si fituese, ndërsa LDK-ja prapa saj, por e vullnetshme për t'u bërë pjesë e qeverisë së re. Duhet sqaruar që në traditën e saj politike LDK-ja kurrë nuk ka pasur 'jo' për ofertat qeverisëse, në kuptimin e partneres në kuadër të koalicioneve, vetëm atëherë kur nuk ka pasur vend. Është e vërtetë se prej fillimi të takimeve mes përfaqësuesve të LV-së dhe LDK-së janë këta të fundit që për çdo ditë nxjerrin figura të ndryshme të kësaj partie me vlerësime e konstatime kundërthënëse. Kuptohet se ka dallime, madje politike dhe ideologjike, mirëpo unë nuk shoh hezitim real nga LDK-ja për të mos qeverisur vendin së bashku me fituesin e zgjedhjeve. Në fakt, ajo që bie në sy është tendenca e kësaj të fundit për ta bërë procesin sa më "interesant" me qëllimin që në fund risku i qeverisjes që do ta fitojë ajo, të jetë sa më i madh.

**"Epoka e re":** Një prej temave që i ndanë këto dy parti në qëndrime është dialogu me Serbinë. A pritet të ketë qartësim në këtë pikë mes tyre?

**Maloku:** Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë, i lehtësuar nga Bashkimi Evropian në formatin e deritanishëm, nuk është se i solli edhe aq Republikës së Kosovës dhe kjo shikuar nga të gjitha rrafshet. Për pasojë, ky format duhet ndërruar. Dhënia e një afati përmbyllës pa analizuar gjendjen në të cilën ndodhet ky dialog dhe çka u realizua mes palëve nga ajo që është nënshkruar apo parafruar, nuk më duket e dobishme për shtetin e Kosovës. Është më se e vërtetë se për këtë dialog nuk pyetet vetëm vullneti i Kosovës ngaqë në të kemi angazhim të shumë palëve, mirëpo nuk besoj se duhet të pranohet gjithçka vetëm sa për ta përmbyllur të njëjtin. Dallimet mes këtyre dy subjekteve politike për dialogun Kosovë - Serbi kanë traditë, mirëpo ashtu siç mund ta dijë LV-ja, se dialogu me formatin aktual nuk i solli edhe aq Kosovës, këtë duhet ta dijë edhe LDK-ja. Të dyja duhet ta gjejnë atë që është më e pranueshme për Kosovën e të distancohen nga shpjegimet e tyre vetjake për çështjen në fjalë. Roli i tyre si subjekte politike që drejtojnë shtetin e Kosovës është të gjejnë zgjidhje jo vetëm për atë se si t'i qasen dialogut, por edhe si t'i qasen Serbisë, po ashtu edhe lehtësuesit deshtak siç ishte Bashkimi Evropian.

**"Epoka e re":** Si e shihni ndarjen e pushtetit në mes të LV-së dhe LDK-së, dhe a mendoni se në këtë pazar duhet të hyjë edhe çështja e presidentit?

**Maloku:** Nëse këto dy subjekte

politike, të cilat i kanë filluar bisedimet për përputhjen e programeve të tyre, e zvarritin procesin e marrëveshjes për shkak të ndarjes së pushtetit, atëherë nuk kemi ndryshim të sistemit të vlerave për të cilën gjë ka nevojë fort ambienti ynë politik. Partitë politike në zgjedhjet e 6 tetorit garuan me emra të shpallur për kandidatë kryeministrash, prandaj vota e vullnetit të votuesve duhet respektuar. Kandidati i LV-së për kryeministër, Albin Kurti, ishte vullneti i qytetarëve të Kosovës në zgjedhjet e 6 tetorit, për ta drejtuar Qeverinë e vendit, ndërsa e dyta doli të jetë Vjosa Osmani. Mesazhi i qytetarëve ishte se duan figura të reja për drejtimin e vendit. Besoj se të dy subjektet politike si partnerë koalicioni kanë në gjirin e vet personalitete kompetente dhe profesionistë për t'i drejtuar dikasteret qeveritare. Kur flasim për Qeverinë e Kosovës, numri prej 12 ministrash është ideal. Tradita e futjes së pozitës së presidentit në pazare politike besoj se duhet të marrë fund njëherë e mirë. Vendi

ka president dhe kjo çështje nuk do të duhej të futej në diskutim. Rekomandimi i kahershëm, që të kemi president të zgjedhur nga populli, vazhdon të ketë vend dhe unë pres që përmes reformës zgjedhore edhe kjo çështje të zgjidhet.

**"Epoka e re":** Sa mund të ketë jetëgjatësi kjo qeveri?

**Maloku:** Për suksesin e Qeverisë së drejtuar nga këto dy rryma të dallueshme politike, pra LV-së dhe LDK-së, nuk mund të flasim me paragjykim, pra duhet t'i shohim e t'i njohim nëpërmjet veprës. Mirëpo, ajo çfarë duhet të ndodhë është që të mos kemi vazhdim të traditës ku Qeveria nuk e përmbyllë mandatin e vet. Kjo gjë po prodhon situata dërrmuese e të padobishme për rrjedhën politike në vend.

**"Epoka e re":** Çfarë roli opozitar pritet nga partitë e ish-Panit, PDK-ja, AAK-ja dhe Nisma, sepse edhe kjo e fundit duket se do të mbetet në opozitë?

**Maloku:** Kur e lavdëruam

procesin zgjedhor të 6 tetorit pa dyshim se nuk e larguam nga vëmendja edhe situatën e krijuar me subjektet politike që kanë ngelur opozitë. Nga ky proces zgjedhor doli edhe një opozitë e re, e cila mund të jetë faktori më stabilizues i rrjedhave politike të cilat e presin Kosovën. E kjo, nga fakti se këto subjekte politike si pjesë kyçe e deritanishme e vendimmarrjes shtetërore mund të flasin edhe nga pozita e atyre që i dinë mundësitë dhe vështirësitë e qeverisjes. Partia Demokratike e Kosovës pas këtyre zgjedhjeve e fitoi rastin t'i vazhdojë reformat e nisura, duke i dhënë potencial më të veçantë në të ardhmen këtij subjekti politik. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës mësimin kryesor që ka mundur ta nxjerrë nga këto zgjedhje është që me kokëfortësi nuk mund të arrihet gjithçka. Ata që e provuan fatin disa herë brenda këtij subjekti politik me kandidaturat e tyre dhe përsëri nuk arritën gjë, do të duhej të largoheshin pa u hamendësuar.



## Mustafa njofton Kosnettin për ecurinë e diskutimeve me LV-në për formimin e qeverisë

Prishtinë, 18 nëntor (ER) - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, së bashku me nënkryetarët e kësaj partie, ka takuar të hënën ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Philip Kosnett. Sipas njoftimit për media të LDK-së, gjatë takimit Mustafa ka njoftuar ambasadorin Kosnett lidhur

me rrjedhën e diskutimeve me Lëvizjen Vetëvendosje sa iu përket çështjeve programore. "Në veçanti u diskutua lidhur me harmonizimin e arritur deri tani në fushën e sundimit të ligjit, ekonomisë, çështjeve sociale, arsimit dhe shëndetësisë. Kryetari Mustafa shprehi interesimin e LDK-së që Kosova sa më shpejt të ketë

institucione funksionale që dalin nga kërkesat e qytetarëve për ndryshim, të shprehura qartë në zgjedhjet e 6 tetorit. Ai, po ashtu, falënderoi Ambasadorin e Shteteve të Bashkuara për përkrahjen e vazhdueshme në të gjitha proceset në të cilat ka kaluar Kosova", është thënë në njoftimin e LDK-së.

të gjithë aktorët pjesëmarrës, me situatën e krijuar, në këtë fazë të rinumërimit të votave. Për mua është e dhimbshme të shoh teksta vjen në shprehje presioni dhe angazhimi i faktorit ndërkombëtar për përmbylljen e procesit zgjedhor të 6 tetorit.

**"Epoka e re":** Tashmë po shohim se LV-ja dhe LDK-ja janë në negociatë për formimin e qeverisë së re. A mund të arrihet një marrëveshje mes këtyre dy partive, pavarësisht se po shohim deklaratatë zyrtare të këtyre subjekteve që janë edhe 'thumbuese' për njëra-tjetrën.

**Maloku:** Nisur nga vullneti i treguar i Lëvizjes Vetëvendosje, shumë kohë më parë, për ta pasur si partner koalicioni Lidhjen Demokratike të Kosovës, konsideroj se ato mund të arrijnë një marrëveshje bashkëpunimi. Në anën tjetër, ekziston edhe një arsye e fuqishme e cila i shtynë drejt bashkimit. Ato përbëjnë alternativën që votuesi i ka ofruar skenës politike në vend për të qeverisur. Këtë e them duke u

## Gjini nënshkruan marrëveshje me organizatën 'Education Comes First'

**GJAKOVË, 18 NËNTOR (ER)** - Komuna e Gjakovës, e përfaqësuar nga kryetari i saj Ardian Gjini, ka nënshkruar të hënën një marrëveshje bashkëpunimi me organizatën joqeveritare "Education Comes First", e cila është përfaqësuar nga drejtoresha ekzekutive e kësaj organizate, Delvina Hajdari. Kjo komunë ka bërë me dije se me këtë marrëveshje parashihet mbajtja e një minimaratonë për fëmijë, ku mjetet e mbledhura nga ky aktivitet do të shfrytëzohen për krijimin e këndit të lojërave për fëmijët

me nevoja të veçanta. "Nënshkrimi i marrëveshjes është vetëm një nismë e vogël drejt një qëllimi human. Më 24 nëntor 2019 do të zhvillohet minimaratonë për fëmijë në dy kategori, 1.5 dhe 3 kilometra. Kjo maratonë na aktivizon të gjithëve për ta shprehur vullnetin tonë të mirë për ta ndërtuar këndin e lojërave për fëmijët me aftësi të kufizuara. Nga sot numrin tuaj do të mund ta siguroni pranë institucioneve shkollore apo në Pallatin e Kulturës 'Asim Vokshi', ka njoftuar Komuna e Gjakovës.



## Suma priti në takim lamtumirës ushtarët polakë të KFOR-it

**HANI I ELEZIT, 18 NËNTOR (ER)** - Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, ka pritur në takim lamtumirës pjesëtarë të LMT-së në kuadër të kontingjentit polak të KFOR-it, të cilët do ta përfundojnë shërbimin në Kosovë. "Kryetari i komunës, Rufki Suma, ka pritur në takim

lamtumirës z. Damian Kedlior dhe Radostan Bejgier, pjesëtarë të LMT-së në kuadër të kontingjentit polak të KFOR-it, të cilët sipas rotacionit standard, përfundojnë shërbimin e tyre në Kosovë", ka njoftuar Komuna e Hanit të Elezit. Sipas këtij njoftimi, mysafirët kanë falënderuar

kryetarin Suma dhe nënkryetarin Mallzum Qajani për bashkëpunimin me njësinë e LMT-së në kuadër të kontingjentit polak të KFOR-it, duke uruar që kjo frymë e bashkëpunimit të vazhdojë dhe pjesëtarët e ardhshëm të shërbejnë në Kosovë.

## Fillon faza pilotuese e teksteve të reja shkollore

**PRIZREN, 18 NËNTOR (ER)** - Komuna e Prizrenit ka njoftuar se gjatë fundjavës ka filluar faza pilotuese e teksteve të reja shkollore e cila është duke u realizuar në bashkëpunim në mes të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe drejtorive komunale të arsimit në nivel të Kosovës. Takimi konsultues i drejtorive komunale të arsimit nga komuna e Prizrenit, e Suharekës, e Dragashit dhe e Mamushës është mbajtur në Prizren, përkatësisht në Shkollën Filllore "Abdyl Frashëri", ku të pranishëm ishin edhe anëtarët e

Këshillit të Ekspertëve të Programeve të Teksteve Shkollore (KEPShT) për pilotimin e teksteve të reja shkollore për klasat nga 0 deri në 11. Në takim kanë marrë pjesë edhe drejtorët dhe koordinatorët e cilësisë së shkollave pilote të këtyre katër komunave. Të gjitha tekstet shkollore të klasave të lartshënuara do të jenë në pilotim gjatë vitit shkollor 2019/2020, ndërsa vetëm ato tekste shkollore të cilat e kalojnë fazën e pilotimit do të vazhdojnë të jenë në përdorim nga mësimdhënësit dhe nxënësit në vitin shkollor 2020/2021.



## Komuna e Malishevës bëhet gati për sezonin e dimrit

**MALISHEVË, 18 NËNTOR (ER)** - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, e ka mbajtur mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, ku drejtorët e drejtorive komunale kanë raportuar për punët dhe aktivitetet e tyre gjatë javës së kaluar dhe planifikimet për javën në vijim. Në këtë mbledhje është bërë me dije gjatë javës së kaluar kanë filluar të realizohen disa projekte dhe disa të tjera pritet të fillojnë në këtë javë. Po ashtu, është bërë me dije se janë duke vazhduar edhe inspektimet në dyqanet dhe restorantet në territorin e Komunës së Malishevës. "Sipas shërbimeve publike, janë duke



vazhduar përgatitjet e nevojshme për sezonin e dimrit, po ashtu edhe për ofrimin e shërbimeve të tjera publike. Edhe ofrimi i shërbimeve administrative

është i kënaqshëm dhe nuk ka ankesa, pasi të gjitha shërbimet ofrohen me kohë dhe pa vonesa", ka njoftuar Komuna e Malishevës.

## Arrijnë tavolina dhe llamba për sallat operative në QKUK dhe për spitalet

**PRISHTINË, 18 NËNTOR** - Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka blerë tavolina dhe llamba për sallat operative në QKUK dhe për spitalet e përgjithshme. "Tavolinat dhe llambat për sallat operative në QKUK dhe spitalet e përgjithshme janë duke u montuar pasi kanë arritur javën e kaluar si pjesë e një kontingjenti me pajisje mjekësore, të blera nga ShSKUK-ja", është bërë me dije në njoftimin e ShSKUK-së.



# Prokuroria Speciale kritikohet për mostrajtim të rasteve të korrupsionit

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës nga 1 janari 2019 e deri më 30 shtator të këtij viti nuk ka ngritur asnjë aktakuzë ndaj profilit të lartë për vepra penale korruptive. Kështu ka bërë me dije hulumtuesja e Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), Arrita Rezniciq, e cila ka prezantuar gjetjet e raportit "Dështimet speciale në luftimin e korrupsionit"



EPOKA  
ERE **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 18 NËNTOR** - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), me përkrahje të Departamentit të Shtetit Amerikan - Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtarë dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe NED-it, të hënën ka mbajtur tryezën me titull "Pandëshkueshmëria e korrupsionit". Në këtë tryezë janë publikuar dy raporte të IKD-së si rezultat i monitorimit dhe hulumtimit sistematik të rasteve të korrupsionit dhe rasteve të tjera në fushën penale në sistemin prokurorial dhe gjyqësor, të cilat raporte përmbajnë gjetjet, vlerësimet dhe rekomandimet konkrete se si të shtohet efikasiteti dhe efektiviteti i këtyre sistemeve në trajtimin e rasteve të korrupsionit dhe si të përmirësohet politika e dënimeve.

Hulumtuesja e IKD-së, Arrita Rezniciq, ka prezantuar gjetjet e raportit "Dështimet speciale në luftimin e korrupsionit", sipas së cilës, prokuroritë dhe gjykatat ende komoditetin e tyre në luftën kundër korrupsionit e bazojnë kryesisht te luftimi i korrupsionit të nivelit të ulët dhe rrallëherë ballafaqohen me rastet e korrupsionit të nivelit të lartë. Sipas saj, edhe sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme përmes veprave penale të korrupsionit ende është një temë tabu dhe pa asnjë rezultat në sistemin prokurorial dhe gjyqësor.

Rezniciq ka pohuar se Prokuroria Speciale edhe këtë vit vazhdon

trendin e ikjes për marrjen e përgjegjësive për trajtimin e rasteve të korrupsionit. "Kjo Prokurori nga 1 janari 2019 e deri më 30 shtator 2019 nuk ka ngritur asnjë aktakuzë ndaj profilit të lartë për vepra penale korruptive. Karakteristika tjetër e PSRK-së ndërlidhet me faktin se prokurorët në këtë prokurori nuk janë të profilizuar dhe specializuar në fusha të veçanta, përfshirë profilizimin në rastet e korrupsionit dhe krimeve ekonomike", ka thënë ajo.

Rezniciq ka bërë me dije se politika ndëshkimore te rastet e korrupsionit ende mbetet sfidë për gjykatësit në të gjitha gjykatat e Kosovës dhe se sistemi gjyqësor ende nuk është në gjendje të zbatojë politika ndëshkimore unike dhe në pajtim me frymën dhe qëllimin e vet Kodit Penal të Kosovës. "Edhe gjatë kësaj periudhe raportuese numri më i madh i dënimeve të shqiptuara nga gjykatat janë dënime me kusht dhe me gjobë, pasuar nga dënimet me burgim. Sidoqoftë, viti 2019, në krahasim me vitet paraprake, për herë të parë ka shënuar ngritje të numrit të dënimeve me burgim efektiv të shqiptuara nga gjykatat e Kosovës", është shprehur ajo.

Hulumtuesja Rezniciq ka theksuar se viti 2019 ka vazhduar të karakterizohet me fenomenin e shtyrjes së numrit të madh të seancave gjyqësore në rastet e korrupsionit dhe mungesën e transparencës dhe llogaridhënies publike nga sistemi gjyqësor dhe ai prokurorial.

Hulumtuesi i IKD-së, Gzim Shala,

ka prezantuar gjetjet e raportit "Politika e dënimeve në Kosovë", sipas të cilit, Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore në Kosovë, i nxjerrë nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës më 15 shkurt 2018, ka pasur fatin e njëjtë sikurse edhe shumë politika dhe dokumente të tjera të miratuara, në kuptimin që i njëjti nuk ka gjetur zbatim në praktikë, por ka mbetur një politikë dhe dokument në letër.

Hulumtimi dhe analizimi i 73 aktgjykimeve, të cilat hyjnë në kategori të ndryshme të veprave penale, e në të cilat gjykatat kanë vendosur me aktgjykime dënuese, sipas Shalës, tregojnë dy dukuri. "E para është se në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës nuk kemi të bëjmë me një praktikë të uniformuar në parim, e cila më pastaj do të konkretizohej varësisht prej specifikave të një rasti. Dhe e dyta, asnjë pjesë e udhëzuesit nuk është zbatuar në nivel të kënaqshëm, që ndryshe mund të përkthehet se udhëzuesi është pothuajse i pazbatuar në praktikë", tha ai.

Në mënyrën se si janë arsyetuar aktgjykimet në pjesën e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimet, përpos moszbatueshmërisë së kërkesave të udhëzuesit, Shala ka thënë se IKD-ja gjen se tanimë

gjykatat kanë ndërtuar disa shabllone të arsyetimit të cilat i aplikojnë në shumicën e aktgjykimeve, pa iu përshtatur specifikave të secilit rast, e cila e gjetur, sipas tij, e rrezon arsyetimin e aktorëve brenda sistemit të drejtësisë se laramanit në politikën ndëshkimore ekzistojnë për shkak se secili rast është specifik, pasi në shabllonet e krijuara nuk kanë ndikuar specifikat e rasteve, por vetë qasja e gjyqtarëve.

Drejtori i INL për Kosovë, i Departamentit Amerikan të Shtetit, Shawn Waddoups, ka thënë se IKD-ja është duke e ndriçuar rrugën në sistemin e drejtësisë dhe se Ambasada Amerikane do t'i mbështesë gjykatësit dhe prokurorët për ta aplikuar Udhëzuesin për Politikë Ndëshkimore në mënyrë efektive. Waddoups ka ftuar të gjithë aktorët e institucioneve të drejtësisë që të bashkëpunojnë për luftimin e korrupsionit dhe zbatimin e ligjit në Kosovë.

Ndërkaq, sipas kryesuesit të KGJK-së, Skënder Çoçaj, vërehet se ka përparim në luftimin e korrupsionit, ndonëse u shpreh se nuk është i kënaqur me nivelin e këtij përparimi, për çka ka thënë se do të punohet edhe më shumë në këtë drejtim dhe se lëndët e kësaj natyre mbeten edhe më tej "top prioritet".

Kurse sa i përket Udhëzuesit për Politikë Ndëshkimore, Çoçaj ka theksuar se është në fazën fillestare të implementimit dhe se, sipas tij, është duke u punuar në drejtim të zbatimit të këtij udhëzuesi në praktikë.

Kryetari i Gjykatës Supreme, Enver Peci, ka deklaruar se IKD-ja po ecën pak më shpejt se gjykatat pasi, sipas tij, raportet në fjalë janë përmbajtësore dhe i prekin disa çështje të cilat janë në interes të përgjithshëm.

Më tutje, kryesuesi i KPK-së, Arben Ismajli, ka thënë se sistemi prokurorial nuk ka lëndë të vjetërsuara dhe se lëndët si ajo e mbetur nga viti 2008 mund të ndodhë për shkaqe të ndryshme pasi që, sipas tij, veçanërisht rastet e korrupsionit trajtohen me prioritet që nga momenti kur ato paraqiten në prokurori. Sa i përket transparencës dhe llogaridhënies së KPK-së, Ismajli ka shtuar se ligji lejon që për shkaqe të konfidencialitetit të jenë më të rezervuar.

Kurse drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka thënë se raportet e IKD-së janë mjet i mirë në ndikimin institucional për qasjen ndaj korrupsionit. Qalaj ka pohuar se institucionet e drejtësisë mund të bëjnë më shumë në luftimin e kësaj dukurie.

## Myftiu Tërnavë shkon për vizitë zyrtare në Arabinë Saudite

**PRISHTINË, 18 NËNTOR (ER)** - Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, me ftesë nga ministri për Çështje Fetare të Arabisë Saudite, po qëndron në vizitë zyrtare disaditore në Arabinë Saudite. Në ditën e parë të vizitës zyrtare Myftiu Tërnavë u prit në takim nga ministri për Çështje Fetare të Arabisë Saudite, dr. Abdul-latif Al-Shejh. Ministri saudit theksoi se Arabia

Saudite, me popullin, qeverinë dhe me mbretin e saj Selman bin Abdulaziz AL Saud dhe trashëgimtarin e Fronit Muhmed bin Selman, janë të përkushtuar për bashkëpunim, mirëqenie dhe prosperitet për të gjithë popujt e botës. Ai theksoi se populli i Kosovës ka vend të veçantë në zemrat e popullit saudit. Myftiu Tërnavë falënderoi Mbretërinë e Arabisë Saudite për



përkrahjen ofruar Kosovës në periudha të ndryshme dhe në sfera të ndryshme. Ai, gjithashtu, e njoftoi nikoqirin me punën dhe aktivitetin e BIK-ut, duke theksuar përkushtimin e Bashkësisë Islame për kultivimin e bashkëjetesës dhe tolerancës ndërfaqetare ndërmjet qytetarëve të Kosovës. Në kuadër të këtij takimi të dyja palët nënshkruan një memorandum bashkëpunimi.

# Rukiqi: 41 për qind e ndërmarrjeve besojnë se arritja e marrëveshjes Kosovë - Serbi ndikon në rritjen e eksportit



PRISHTINE, 18 NËNTOR (ER) - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, në një konferencë për medie ka prezantuar të hënën hulumtimin rreth opinionit të bizneseve për marrëveshjen Kosovë - Serbi. Sipas këtij hulumtimi, Rukiqi ka thënë se 41 për qind e ndërmarrjeve të Kosovës konsiderojnë se në rast të arritjes së marrëveshjes Kosovë - Serbi do të rritet eksporti. "Në pyetjen se sa ka ndikuar Serbia në zhvillimin e bizneseve kosovare, 75 për qind e bizneseve thonë se ka pasur ndikim negativ, pra është një shoqëri dërrmuese që beson se komplet këtë periudhë Kosova ka pasur mundësi për një

zhvillim shumë më të shpejtë ekonomik. Serbia ka pasur ndikim negativ për shumë arsye dhe ajo më kryesorja është kufizimi i eksportit, humbja e tregjeve, konkurrenca e padrejtë e shumë të tjera", ka thënë Rukiqi. Sipas tij, në pyetjen që lidhet me marrëveshjen finale në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe në atë se sa do të ndikojë që Kosova të jetë në një performancë më të mirë në zhvillimet e bizneseve nga rajoni, 41 për qind e ndërmarrjeve konsiderojnë se po, ndërsa 33 për qind ndoshta, kurse vetëm 16 për qind e ndërmarrjeve nuk konsiderojnë se do të ketë ndikim në rritjen e eksportit nga kjo marrëveshje.

## Në Mynih u mbajt sesiioni informues 'Klima e investimeve në Kosovë'



MYNIH, 18 NËNTOR (ER) - Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike ka organizuar në Mynih të Gjermanisë, sesiionin informues "Klima e investimeve në Kosovë". Me këtë rast, bizneset pjesëmarrëse të diasporës u informuan për shërbimet e KIESA-s, shkëmbimet tregtare, statistikak e

investimeve dhe të tjera informata lidhur me investimet Kosovë - Gjermani. Drejtoresha e Departamentit për Hulumtime dhe Përkrahje të Investimeve të Diasporës, Shqipe Krasniqi, foli për projektet konkrete të cilat MDIS-i ka ndërmarrë siç janë: themelimi i grupit

të punës për hartimin e koncept-dokumentit për lehtësimin e investimeve nga diaspora. "Ky grup është i përbërë nga institucione relevante dhe biznese nga diaspora, për të krijuar një klimë më të favorshme për të bërë biznes në Kosovë", ka thënë Krasniqi, duke shtuar se përmes këtij grupi

do të mundësohet një shkëmbim përvojash me shtetet si Italia, Kroacia, Irlanda e të tjera. Krasniqi ka prezantuar edhe platformën "online" DIKOS, e cila mundëson komunikim mes bizneseve të diasporës. Përmes DIKOS-it do të krijohet bashkëpunimi me komuna, duke

bërë kështu një mekanizëm lokal që ndikon në nxitjen e investimeve nga diaspora. Në këtë sesion u bë prezantimi i verërave të Kosovës. Ndër verat që u prezantuan ishin: "Stone Castle", "Daka Wine", "Labi Wine", "Bodrumi i Vjetër Rahovec", "Suhareka Verari", "Eko Rahovec", "Kosova Wine".



# Fillon 'Java Globale e Ndërmarrësisë', marrin pjesë rreth 60 biznese të reja

Në 180 shtete të botës ka filluar "Java e Ndërmarrësisë Globale", me mbi 10 milionë pjesëmarrës, kurse në Kosovë do të jetë e hapur deri të dielën. Drejtori ekzekutiv i Qendrës së Inovacionit të Kosovës, Uranik Begu, ka thënë se janë bërë bashkë rreth 60 organizata në kuadër të këtij organizimi dhe se brenda javës do të mbahen mbi 80 aktivitete



**EPOKA  
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 18 NËNTOR** - Qendra e Inovacionit të Kosovës (ICK) dhe Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) kanë mbajtur të hënën ceremoninë e hapjes së "Javës Globale të Ndërmarrësisë 2019" në Kosovë. Në 180 shtete të botës ka filluar "Java e Ndërmarrësisë Globale" me mbi 10 milionë pjesëmarrës, kurse në Kosovë do të jetë e hapur deri të dielën.

Uranik Begu, drejtor ekzekutiv i Qendrës së Inovacionit të Kosovës, ka thënë se në kuadër të këtij organizimi dhe brenda javës do të mbahen mbi 80 aktivitete. "Jemi rreth 60 organizata të cilat jemi bashkuar. Shtatë vjet më parë nuk kemi menduar që nuk do ta kemi lëvizjen e lirë. Bashkimi i forcave

na bën të besojmë se ky vend ka një të ardhme të ndritur nëse investojmë në atë që të rinjtë besojnë. Java e ndërmarrësisë sot fillon në 180 shtete. Gjatë javës do të kemi mbi 80 aktivitete", u shpreh Begu.

Kurse kryetari i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK), Arian Zeka, ka thënë se është e rëndësishme që bizneset të shohin perspektivë në vendin tonë. "Është e rëndësishme t'ju themi se edhe këtu mund t'ia dilni që të bëni storie të suksessit siç kanë bërë shumë të tjerë", ka thënë Zeka, duke shtuar se 14 aktivitete përgjatë tërë javës do të mbahen nëpër qytete të ndryshme në Kosovë. "Më vjen jashtëzakonisht mirë që jemi partnerë me ICK-në dhe për të satën herë më radhë kemi mundësinë që të organizojmë aktivitete në kuadër të Javës

Globale të Ndërmarrësisë. E di që para tri vjetësh kemi pasur numrin më të madh të aktiviteteve, gjashtë nëse s'gaboje dhe kemi dashur ta thyejmë këtë rekord. Këtë vit i kemi 14 aktivitete përgjatë tërë javës nëpër qytete të ndryshme dhe me shumë partnerë", ka thënë Zeka, duke shtuar se jemi në një kohë kur një pjesë e të rinjve tanë nuk shohin perspektivë në vendin tonë dhe besoj se thelbi kryesor i të gjitha aktiviteteve tona gjatë tërë javës duhet të jetë pikërisht kjo: që të ndajmë sa më

shumë storie suksesi me këta të rinj, që t'u tregojmë atyre se është e mundur që t'ia dalësh edhe në Kosovë.

Kurse ambasadorja e Kosovës në ShBA, Vlora Çitaku, ka thënë se në dhjetë vjetët e fundit numri i kompanive të IT-së në Kosovë është rritur për 185 për qind. "Fakti kryesor se pse jemi mbledhur këtu, pas një nate të gjatë, tregon se sa të përkushtuar jemi. Më duhet të them se ICK ka qenë një nga storiet e shkëlqyera të suksessit që Kosova ka arritur të prodhojë prejse e kemi shpallur

pavarësinë. Është rinia jonë, shpirti sipërmarrës që do ta çojë dhe shtyjë Kosovën përpara. Shumë pak njerëz dinë se rreth 60 për qind e GDP-së vjen nga shërbimet dhe nga të talentuarit e industrive të teknologjisë që po lulëzojnë në Kosovë. Vetëm në 10 vjetët e kaluar numri i kompanive që lidhen me IT është rritur për 185 për qind. Ky përparim nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen e të gjithë juve, veçanërisht të ICK-së dhe storiet e shkëlqyera që ju arritët t'i bëni", u shpreh ajo.

## Edhe një protestë kundër rritjes së çmimit për sigurim të veturave



**PRISHTINË, 18 NËNTOR (ER)** - Edhe një tjetër protestë është paralajmëruar kundër vendimit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) për rritjen e çmimit për

sigurim të veturave. Pas paralajmërimit të protestës nga grupi "Speedomaniaks" për të shtunën, më 23 nëntor, tani ka ardhur një paralajmërim tjetër

për protestë nga grupi i "Marakli t'kerreve".

Grupi "Marakli t'kerreve" ka bërë thirrje për protestë paqësore dhe pa vetura te rruga

"Luan Haradinaj", pranë BQK-së, më 22 nëntor (e premte) nga ora 13:00.

Gjithashtu, të dielën kundër vendimit të BQK-së ka nisur

edhe një peticion online. E lidhur me këtë çështje Banka Qendrore e Kosovës ka paralajmëruar konferencë për medie këtë të enjte.

# GJYKATA SPECIALE, INKUIZICIONI MODERN DHE DHUNIM I KUJTESËS!



Behxhet Sh.  
SHALA - BAJGORA

**Parashikuesit dhe dhunesit:** Themelimi i Dhomave të Specializuara me seli në Hagë, "sipas ligjeve të Kosovës", është bërë në kushte dhe rrethana të terrorizimit, së pari të politikanëve "vendimmarrës" kosovarë të cilët pastaj kanë terrorizuar deputetët e Kuvendit të Kosovës ta votojnë këtë gjykatë raciste, me të vetmen shpresë se do ta shpëtojnë pjesën më të dobët të anatomisë së tyre, prapancën. Të gjithë ata që kanë qenë në Kuvendin e Kosovës, qoftë si deputetë, vëzhgues, "miq" ndërkombëtarë apo në ndonjë cilësi tjetër, e kanë të qartë se në çfarë rrethana është votuar themelimi i kësaj gjykate e cila, mund lirisht të jetë edhe gjykatë e Bangladeshit, por jo e Kosovës. Pse e them këtë? Qytetarët dhe pjesëtarët e fiseve të Bangladeshit kanë qenë në përbërje të misioneve ndërkombëtare në shumë vende të botës, madje edhe në Kosovë ku, pas përfundimit të luftës kanë kontribuar jashtëzakonisht shumë në ndërtimin dhe konsolidimin e demokracisë, shtetit të së drejtës dhe zbatimit të ligjit e sidomos në luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar. Kjo mundësi u është mohuar qytetarëve të Kosovës të cilët nuk kanë pasur as mundësi teorike të shërbejnë në misionë ndërkombëtare përveçse e kanë denoncuar, për pak para njëri-tjetrit duke e vazhduar kështu traditën që nga koha e Jugosllavisë së kriminelit Tito dhe Serbisë së "humanistit" Sllobodan Millosheviq. Në atë kohë e kam kundërshtuar këtë gjykatë si nga forma e sidomos nga përmbajtja apo mandati që ia ka caktuar vetes sepse, në të njëjtën kohë ndanë drejtësi dhe padrejtësi ekskluzivisht sipas parimit etnik dhe nevojave politike. Disa shokë të burgut më kundërshtonin duke pohuar se ky qenka projekt amerikan jo për ta demonizuar luftën e UÇK-së, por se qëllimi i vetëm qenka që përmes intervistimit të jo më shumë se 10 vetave përfundimisht të pastrohet UÇK-ja dhe këta ta vazhdojnë "ëndrrën e një nate vere" e që, me gjasë, do të shndërrohet në ankth dhe makth shumëvjeçar

të vet atyre që e votuan këtë gjykatë. Është rregull i pashkruar që ai që e merr njësh (1) në histori, në matematikë nuk e kalon as zeron (0), që nënkupton se llogaritë kurrë nuk i dalin sipas matematikës që e bëjnë. Kjo gjykatë e Bangladeshit katërçipërisht e vërteton këtë. Nëse dikush ka llogaritur se, duke ia ngulur Hasanit, do të shpëtojë Hyseni, tashmë po vërtetohet se ka qenë një gabim i cili, vetëm nëse do të ktheheshin disa vjet pas, nuk do ta bënin. Babai politik i disa politikanëve të shquar në Kosovë apo edhe i trashëgimisë së pistë të tyre, Sllobodan Millosheviqit, me dëshirën më të madhe e kanë përkrahur dhe e përkrahin këtë gjykatë sepse, edhe në kohën kur lufta e lavdishme e UÇK-së bëhej në kushte kur fasulja hahej kokërr për kokërr, llogaritej si lojtari kryesor i ndërtimit të paqes në Ballkan ndonëse, edhe gjatë Konferencës së Dejtonit duart i kishte të përgjakura, sigurisht se kishte premtime se nuk do të burgosej. Pastaj, vetë serbët e lidhën këmbë e duar dhe e dërguan në Burgun e Sheveningenit. Edhe Alia Izetbegoviqi, kryetar i Bosnjës dhe Hercegovinës, sikur edhe Franjo Tuxhmani, kryetar i Kroacisë, ndonëse bënë luftë mbrojtëse, të drejtë dhe çlirimtare, kishin aktakuzave pasive që do të aktivizoheshin në momentin e duhur, po të mos ua dërgonte Zoti aktgjykimin e pakthyeshëm për përfundimin e jetës së tyre. Rasti i fundit ishte ai i Radovan Karaxhiqit i cili gjatë arrestimit tha se ka pasur premtime të forta nga Riçard Hollbruk se do të falej nga përgjegjësia penale nëse zhduket nga jeta politike në B dhe H. Madje e ftoi të jetë dëshmitar duke llogaritur në korrektësinë dhe nderin e fjalës së dhënë. Përgjigja e Hollbrukut ishte tipike me të tjerët: "Nuk pranoj të dëshmoj para një kriminelit luftë..."! Nëse ndërkombëtarët kanë trajtuar, si i kanë trajtuar Millosheviqin, Izetbegoviqin, Tuxhmanin, Karaxhiqin dhe të tjerët, vëllezër dhe motra të dyshuar për krime lufte, vetëm budallenjtë kanë besuar se këta që po ftohen sot nga gjykata e Bangladeshit do të trajtohen ndryshe. Dhe kjo është ajo lidhja e notave midis historisë dhe matematikës. Të gjitha gjykatat për krime lufte për ish-Jugosllavinë, qofshin ato vetëm nga ndërkombëtarë, hibridë, apo me përbërje gjyqësore krejtësisht vendore, në aspektin e ndarjes së drejtësisë dhe padrejtësisë, janë më të drejta dhe më humane se kjo

Gjykata Speciale e Bangladeshit, e ambalazhuar me pronësi të Kosovës, për faktin se i kanë trajtuar rastet duke mos bërë dallime sipas parimit etnik apo nevojave politike të kohës. Menjëherë pas theme-limit të kësaj gjykate "të Kosovës" në skenë dolën "analistët e drejtësisë" dhe "njohësit apo ekspertët ndërkombëtarë" që parashihnin se kush do të ftohej nga kjo gjykatë, kur do të ftohen, kur do të ndodhin arrestimet e para, kush ka dëshmuar dhe çka ka dëshmuar dhe marrëzira të tjera ordinere me të cilat nuk do të merrej as "baba Vanga e verbër" e cila ka parë shumë më qartë dhe shumë më larg se këta "qorrat" tanë analistë që mbijetojnë duke siguruar praninë e tyre përmes parashikimeve që asnjëherë nuk iu dalin të sakta. Janë përralla pohimet se "disave u janë konfiskuar pasaportat", kurse "disa të tjerëve u është thënë t'i marrin teshat me vete thuaja se në burg shkohet lakuriq...". Nuk ka polici apo gjykatë që i tregon të dyshuarit se kur dhe si do të arrestohet e sidomos nuk do ta bënte kjo gjykatë e Bangladeshit veprimet e së cilës, së paku deri më tani, i ngjajnë një prostitucioni juridik.

**Mbi pastërtinë e luftës dhe faqeve të bardha në një mjedis krejtësisht të ndyrë:** Që nga përfundimi i luftës në Kosovë është kënduar thuaja e njëjta këngë: "Se ne nuk mund të arrestohemi, të gjykohe mi dhe të dënohemi për krime lufte shkak se kemi bërë luftë mbrojtëse, çlirimtare dhe nuk kemi sulmuar ndonjë shtet tjetër...". Për ma keq, këtë e kanë thënë, sigurisht nga frika dhe e kaluara e tyre komprometuese, edhe disa personalitete që njihen si autoritete juridike, ndonëse me politikën e tyre dhe shërbimet që i kanë bërë çdo regjimi, kanë kontribuar 100 për qind në arrestimin dhe gjykimin tonë, si armiq të Jugosllavisë dhe Serbisë, rrënues të shtetit dhe rrezikues të pushtetit të vëllazërim-bashkimit e që sot përkthehet si multietnicitet... Këto "autoritete" kanë edukuar mijëra dhe qindra - mijëra studentë në frymën e patriotizmit jugosllavë, luftëtarë të socializmit vetëqeverisës si dhe gardianë të vëllazërim-bashkimit. Po këta qyqarë pas luftës janë paguar mirë dhe mirë duke i zënë deri në shtatë vende pune në kohën kur shumica e ish të burgosurve politikë, luftëtarë të së lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës, veteranë të vërtetë,

invalidë të luftës, viktima të dhunës seksuale dhe të tjera ishin shndërruar në kategori sociale. Madje, një horr dhe një i paditur në fushën e drejtësisë, në kohën kur ngjente dhe lëpinte, së paku shtatë pjata (rroga), më thoshte se ja: "Baca Adem u shit te Hashim Thaçi për 1 000 euro...". Kam reaguar tepër butë (sikur të gjithë të burgosurit politikë shqiptarë dhe luftëtarët e vërtetë të UÇK-së që falin edhe kur nuk duhet të falin duke duruar edhe fundërrinën më të ndyrë njerëzore, duke e larguar nga tavolina ku ishte ulur...). Tash këta horra e përkrahin Gjykatën Speciale të Bangladeshit sepse ua kujton të kaluarën e ndyrë të tyre kur luanin me fatin e të tjerëve që nuk donin asgjë më shumë se të jetojnë të barabartë, të jenë të lirë dhe të përfillet vullneti i tyre. Unë nuk ndaj mendimin me ta dhe nuk besoj se ka luftë të pastër. Nuk ka pastërti aty ku vriten njerëzit, ku dhunohen njerëzit, ku shpërngulen me dhunë nga vatrat e tyre, ku ka shkatërrime materiale që përdoren si mjet lufte dhe ku zbatohet vetëgjyqësia. Lufta çlirimtare dhe lufta mbrojtëse janë luftëra të drejta, por se nuk janë të pastra dhe nuk ju amnistojnë nga krimet eventuale që mund t'i keni bërë apo nuk i keni penguar, ndonëse keni pasur mundësi ta bëni këtë. Të gjitha luftërat janë të ndyra, disa më pak të ndyra, kurse disa shumë të ndyra. Ka shumë raste që e dëshmojnë këtë. Lufta Çlirimtare e Kosovës ka qenë luftë e drejtë, çlirimtare, e imponuar, mbrojtëse, por jo krejtësisht e pastër sepse ka pasur viktima të të gjitha përkatësive etnike. Sidomos është komprometuese dhe e errët periudha pas përfundimit të luftës e cila duhet të sqarohet, nëse duam ta ndërtojmë paqen e qëndrueshme. Në Ballkan është një rregull i kodifikuar se: "Kriminelët tanë janë heronj, kurse ata të palës tjetër janë kriminelë e shkuar kriminelëve...". Sidomos për krime të luftës. Është gjithashtu e ditur se rruga më e lehtë dhe më e shkurtër të bëheni hero është nëse arrestoheni, gjykoheni dhe dënoheni për krime lufte ani pse nuk keni lënë të zezë pa bërë pas përfundimit të luftës e për të cilën po shpëtoni pa u dënuar. Fatura për krime lufte është shumë më e vlefshme se profaktura për korrupsion, krim të organizuar, nepotizëm dhe rrënim të themelit ekonomik dhe juridik të shtetit. Kurrë nuk do ta pranoj Gjykatën e Bangladeshit, jo pse angazhohet

për drejtësi për të gjitha viktimat dhe përgjegjësi për të gjithë ata që u dëshmohe krimet, por se po vepron në kundërshtim të plotë me këto parime; siguron drejtësi në baza etnike dhe politike në bazë të një Raporti puro politik të një personaliteti të dyshimtë në çdo aspekt, ua mohon të drejtën për drejtësi 98 për qind të viktimave pikërisht pse janë të një etnie tjetër, ndjek dhe dënon përgjegjësinë për krime ndaj vetëm të një komuniteti etnik, kurse shpërfillë drejtësinë dhe amnistion nga çdo lloj përgjegjësie më shumë se 98 për qind të një komuniteti që ka përgjegjësi objektive dhe të argumentuar për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit në Kosovë. Këtë nuk mund ta gëlltisë kurrë dhe asnjëherë. Këto janë faktet që është dashur të përdoren në refuzimin e formimit të kësaj gjykate dhe është dashur thjesht të veprohet sipas formulës: drejtësi për të gjitha viktimat dhe përgjegjësi për të gjithë ata që u dëshmohe se kanë bërë krime, pa bërë asnjë dallim. Gjykata Speciale e Bangladeshit është formuar në rrethana terrori dhe presioni të madh dhe si rezultat i një raporti krejtësisht politik të një ekzibicionisti, voajeri dhe urrejtësi patologjik të çdo gjëje shqiptare, siç ishte rasti i Dik Martit. Ky mashtrues nuk pati përgjigje të organizuar të shtetit, por pati dorëzim të improvizuar të "krerëve të shtetit", të një ish-komunisti dhe një ish-komandanti politik. I pari shpëtoi pa therë në këmbë, kurse të dytë i dërsitet prapancën edhe në temperatura ekstremisht të ulëta. Nuk shkohet faqebardhë në këtë gjykatë, por mund të ktheheni faqebardhë nëse merrni përgjegjësi, e mbronni ushtarin dhe e mbronni luftën sikur që nuk i arsyetoni krimet ndaj të tjerëve. Ktheheni faqebardhë nëse kërkoni përgjegjësi dhe drejtësi për viktimat e palës tjetër. Nëse krahasohet lufta e së lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës me luftërat e tjera, proporcioni i shkeljes së zakoneve të luftës dhe të drejtës humanitare është shumë i ulët në Kosovë. Kujtojin krimet gjatë luftës së dytë botërore që i bëne nazistët gjermanë, partizanët e Ruisë, komunistët e Jugosllavisë dhe të Shqipërisë, Lëvizja e Rezistencës në Francë, japonezët në Mongoli dhe në Kinë, amerikanët në Vietnam dhe shtetet e tjera, gjenocidi në Ruandë, në Kongo, Peru, Argentinë, Kil dhe Spanjë, Metaksai në Çamëri dhe bindeni lehtë për atë se çka ka

ndodhur në Kosovë.

### Pritjet e mëdha, zhgënjimet

**edhe më të mëdha:** Para, gjatë dhe pas përfundimit të luftës në Kosovë kanë ndodhur gjëra të shëmtuara, janë zhdukur pa nam dhe nishan personalitete politike, shkrimtarë, avokatë, luftëtarë, çlirimtarë e më së paku tradhtarë. Nuk ka asgjë më njerëzore, ligjore dhe morale se të kërkon informata për anëtarin e familjes apo atë që e ka pësuar në rrethana të dyshimta e që deri më sot nuk ka përgjigje. Të gjitha gjykatat, që nga Tribunali i Hagës dhe pjesë e zorrëve të kësaj gjykate, gjykatat e UNMIK-ut apo ato të EULESH-it dyshohet të kenë bërë përpjekje për nxjerrje para përgjegjësive të fajtorëve për këto tragjedi personale dhe familjare. Për këto tragjedi njerëzore, kombëtare dhe shtetërore. Tash, të gjitha shpresat i varin te gjykata e Bangladeshit e që qenka themeluar dhe do të punojë sipas ligjeve të Kosovës,

ndonëse kosovarët do të jenë vetëm në cilësinë e dëshmitarit, të dyshuarit, të arrestuarit, të dënuarit dhe të persektuarit. Këta që aq shumë po i gëzohen kësaj gjykate do të zhgënjehen më së shumti sepse ekzibicionisti, voajeri, aventurieri dhe urreyesi i shqiptarëve, Dik Marti, kërkon drejtësi vetëm për viktima të një komuniteti dhe i shërben vetëm një sahani të prodhuar në Svetozarevë. Kjo gjykatë është mandatuar t'i trajtojë vetëm rastet e përfshira në raportin politik të Dik Martit dhe jo për t'i hetuar apo nxjerrë para drejtësisë ata që kanë përgjegjësi për vrasjet dhe zhdukjet pas 31 dhjetorit të vitit 2000. Vetëm nëse në ndërkohë e zgjeron mandatin. Shumë do të mbesin, pa fajin e tyre të zhgënjyer dhe shumë viktima do të mbesin të patrajtuara sidomos për rastet që nuk janë pjesë e këtij raporti. Lërin profesorët e kriminelit Tito që ju mashtrjnë dhe bëjnë përpjekje t'i përshtaten çdo regjimi dhe çdo sahani apo grazhdi! Gjykata e Bangladeshit

nuk ka për qëllim drejtësinë, por ka për qëllim imponimin e marrëveshjeve politike përmes paqes së imponuar, kryesisht në dëm të viktimës. E keni Srebrenicën e Bosnjës, viktimat kërkojnë mbetje mortore, kriminelët janë në krye të politikës. Edhe te ne nënat gjakovare dhe ato shqiptare, por edhe serbe dhe komunitete të tjera shtrojnë pjata në tavolinë edhe për anëtarët e zhdukur të familjeve të tyre, kurse kriminelët e bëjnë politikën duke fshehur çdo gjurmë krimi. Me ndihmën e ndërkombëtarëve, pa asnjë dyshim. Po shihni si janë rehatuar mercenarët juridikë (hetues, prokurorë dhe gjykatës) të ish-Tribunalit të Hagës, mbeturinat e gjykatave të UNMIK-ut dhe EULESH-it, në Gjykatën Speciale të Bangladeshit! Për punën e bërë leshko janë shpërblyer me miliona euro dhe kështu do të bëjnë edhe në këtë gjykatë raciste, Gjykatën Speciale të Bangladeshit! A mbeti kush pa u ftuar nga gjykata e Bangladeshit? Deri më

tani, nga vlerat njerëzore, morale, politike dhe kombëtare, të njohura edhe ndërkombëtarisht, që nga Lupçi i Epërm ku i kam dajat e deri te Mareci legjendar, të kursyera nga gjykata e Bangladeshit janë vetëm dy vlera të pakundërshtueshme: Behgjet Pacolli, me përkatësi shtetërore, ndër të tjera, edhe kosovar dhe Behxhet Shala, me përkatësi etnike supershqiptare, por me pasaportë kosovare. Mirëpo këtu nuk është fundi i lojës sepse lehtë mund të ftohemi, njëri si dëshmitar i besueshëm, kurse tjetri si dëshmitar i dyshuar. Që të dy njihemi si personalitete që i njej bota, që e flasim shkëlqyeshëm gjuhën e Aleksandër Vuçiqit e, deri-diku, edhe gjuhën shqipe, jemi pozitivë deri në negativitetin ekstrem, se jemi të sinqertë deri kur na sosën të gjitha rrenat dhe se tërë qenien e kemi në shërbim të njerëzimit atëherë kur nuk na lejohet të punojmë për veten tonë. Njëri i beson Myfti Naimit e tjetri Pashko

Vasës, ndonëse jemi myslimanë. Deri në kohën kur Behgjeti dhe Behxheti janë larg Hagës, Kosova është mirë, kurse këta që ftohen në Hagë nuk mund të ndjehen aq të sigurt.

Sot në mëngjes e thirra një mik të zemrës, të mirë dhe të moçëm dhe i cili objektivist mund ta bëjë një shëtitje deri në Hagë sipas formulimit të juristit të shquar Remi, si dëshmitar shumë i dyshuar, për kafe të mëngjesit, por më refuzoi sepse mbrëmë paska qëndruar deri vonë, pas lojës me Anglinë. Dhe, këtij refuzimi i bashkëngjiti një lutje për Albin Kurtin i cili llogaritet si shqiptar i perezistueshëm të mos vijë më në lojërat kur luan Kosova sepse, prej kohës që Albini po e përkrah Kosovën, nuk e kemi fituar asnjë lojë. Madje, e citoi atë plakën legjendare të Reçakut që e pati falënderuar kryeministrin Rexhepi me fjalët: "Na ke ndihmu, na ke ndihmu, na ke kapt nanën..." Pastaj, nuk i ka hije që një Albin shqiptari ta luajë rolin e një kosovari!

## 'Çohu' publikon raportin 'Qasja në drejtësi'



**PRISHTINË, 18 NËNTOR (ER)** - Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet "Çohu" të hënën e ka publikuar raportin "Qasja në drejtësi". Gjatë periudhës njëvjeçare "Çohu" ka monitoruar 242 raste, apo 575 seanca gjyqësore në gjykatat themelore në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Ferizaj, Prizren, Gjilan dhe Gjakovë, ku janë identifikuar një varg gjetjesh nga ato më teknike e deri te shkeljet e afateve procedurale dhe shkeljet e të drejtave të njeriut. "Çohu" ka realizuar edhe tri hulumtime në fushën e drejtë-

sisë: korrupsioni i nivelit të lartë, drejtësia në Mitrovicë, si dhe performanca e gjykatësve dhe prokurorëve.

Raporti ka analizuar të dhënat nga Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial që tregojnë se, përkundër prioritetit që do të duhej të kishin lëndët e korrupsionit dhe krimet të organizuar, ato vazhdojnë të barten nga viti në vit.

Gjetjet e këtij raporti para përfaqësuesve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial si dhe përfaqësuesve të ambasadës holandeze, e cila ka mundësuar realizimin e

këtij projekti, përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe mediave, i ka prezantuar hulumtuesja Rina Koliqi. Ndër gjetjet e këtij raporti mund të veçohen vonesa dhe shtyrja e seancave gjyqësore, ndërprerja e seancave gjyqësore, shkelja e afateve ligjore, parashkrimi i lëndëve, përfaqësi i aktakuzave, papërgatitja e prokurorëve dhe ndryshimi i përbërjes së trupit gjyqësor. Një prej problemeve që janë identifikuar në këtë raport është edhe parashkrimi i lëndëve kundër korrupsionit. Sipas këtij raporti, gjatë periudhës 2013-

2018 janë parashkruar 58 lëndë kundër korrupsionit. Në anën tjetër, monitorimi njëvjeçar ka identifikuar vetëm 17 raste të korrupsionit të nivelit të lartë në të cilat janë të përfshirë deputetë, ministra dhe kryetarë të komunave.

Ambasadorja e Holandës, Gerrie Willems, e ka vlerësuar punën e organizatës "Çohu" duke shprehur se rastet e identifikuar në raport do të adresohen në të ardhmen. Ajo i ka përshëndetur edhe gjykatat dhe prokuroritë që po tregohen mjaft transparente me organizatat e shoqërisë

civile.

Bahri Hyseni, kryesues i KPK-së, ka folur për mekanizmat e vlerësimit të performancës së prokurorëve. Sipas tij, vitet e fundit këta mekanizma kanë funksionuar si duhet dhe shumë prokurorë janë ndëshkuar në rastet kur nuk e kanë bërë punën si duhet.

Ish-kryetarja e Komisionit për Legjislacion në Kuvendin e Kosovës, Albulena Haxhiu, i cila ishte pjesë e panelit, ka përmendur rritjen e buxhetit si parakusht për funksionimin e duhur të sektorit të drejtësisë.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



Shijo  
Pranverën  
me...



**E rrallë**

## Djaloshi me kancer kërkoi vetura sportive në funeral, i shkuan 2 100 të tilla

Kur një adoleshent amerikan po vdiste nga kanceri, dëshira e tij e fundit ishte që nga shtëpia në varr të përcillej me vetura sportive. Dëshira e tij u plotësua. Mbi 2 100 vetura super-sportive morën pjesë në funeral. Alec Ingram, një djalosh 14 vjeç nga Missouri, vdiq



më 7 nëntor pasi e humbi betejën me kancerin, të cilën e kishte nisur para katër vjetësh. Ai në vitin 2015 ishte diagnostikuar me osteosarcoma, një formë e rrallë e kancerit të eshtrave.

**FOTO E DITES**



Aeroplanët francezë shfaqin flamurin e Francës gjatë një shfaqjeje në Emiratet e Bashkuara Arabe /AP/

**E jashtëzakonshme**

## Fëmijët "peshkojnë" municionin e Luftës së Dytë Botërore

Tre fëmijë në Gjermaninë lindore kanë "peshkuar" predha dhe plumba të ndryshkur të Luftës së Dytë Botërore nga një pellg duke përdorur një magnet të fuqishëm. Ata telefonuan policinë kur bënë zbulimin afër qytetit të Ohrdrufit.

Policia rrethoi zonën dhe u bëri thirrje njerëzve të raportojnë çdo gjetje të tillë menjëherë dhe të



mos i prekin municionet. Nuk është e qartë pse municionet janë hedhur në pellgun me ujë. Bombat e pashpërthyer të WW2 gjenden shpesh në Gjermani, duke shkaktuar evakuime masive.

**BARSOLETA E DITËS**



Një fëmijë i vogël rrihet nga fqinja. Nëna e tij shumë e nevrikosur shkon për t'i kërkuar shpjegime:

- A mund ta di pse e ke rrahur djalin tim?
- Është i paedukuar. Më tha trashaluçe.
- Dhe çfarë mendoni ju zonjë, se duke e rrahur djalin tim do të dobësoheni?



**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Vetem gjatë vikendit në ora

14:00

### ABOMINABLE 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 32 min

Rolet: Chloe Bennet, Tenzing Norgay Trainor, Albert Tsai, Eddie Izzard, Sarah Paulson, Tsai Chin, Michelle Wong, etj.  
Regjia: Jill Culton



Çdo ditë në ora 16:00

### TOY STORY 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.  
Regjia: Josh Cooley



Çdo ditë në ora 18:00 dhe 20:00

### MALEFICENT MISTRESS OF EVIL 3D

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 orë 58 min

Rolet: Angelina Jolie, Elle Fanning, Chiwetel Ejiofor, Sam Riley, Ed Skrein, Imelda Staunton, Juno Temple, Michelle Pfeiffer, etj.  
Regjia: Joachim Ronning



Çdo ditë në ora 22:00

### ZOMBIELAND DOUBLE TAP

Aksion/Komedi/Horror; 1 orë 39 min

Rolet: Woody Harrelson, Jesse Eisenberg, Emma Stone, Abigail Breslin, Rosario Dawson, Zoey Deutch, Luke Wilson, etj.

Regjia: Ruben Fleischer



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p><b>DASHI</b> T'i bëni gjërat me forcë nuk do t'ju bëjë që të realizoni qëllimet tuaja. Ju nuk mund t'i shtyni njerëzit të jenë atje ku dëshironi që ata të jenë, sepse ata duhet të arrijnë vetë atje.</p>	 <p><b>DEMI</b> Ju dhe një mik po afroheni më afër dhe duket se secili prej jush është tifozi më i madh i tjetrit! Por kjo shoqëri admirimi e ndërsjellë që ju filluat do të jetë e tepërt për disa të tjerë, prandaj kini kujdes që të dy mos dërgoni mesazhe të gabuara.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Sot, duhet të kuptoni ndryshimin midis një beteje nga e cila mund të fitoni, dhe një luftë nga e cila thjesht duhet të largoheni. Ju keni harxhuar shumë energji dhe durim në një seri pengesash që thjesht nuk do largohen. Ky nuk është një dështim, por vendim i mençur strategjik.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Ide të çuditshme do të vijnë sot në kokën tuaj majtas dhe djathtas dhe sa më të çmendura të jenë, aq më mirë! Nëse jeni duke punuar për të ndërtuar një romancë, duke ndërtuar një rrjet karriere, ose thjesht duke trajtuar një projekt sfidues, mund ta arrini qëllimin tuaj shumë shpejt.</p>	 <p><b>LUANI</b> Partneri juaj mendon se ai ose ajo di më së miri për një projekt të caktuar sot, por ju e dini më mirë ose të paktën ju mendoni se e dini. Gjërat janë paksa të tensionuara tani, dhe ndoshta duhet të bëni lojë të sigurt. Kjo gjë vien edhe në aspektin romantik.</p>	 <p><b>VIRGJERESHA</b> Sot, ndjenjat do t'ju pengojnë në rrugën tuaj duke ju larguar nga realizimi i asaj që duhet të bëni. Pra, nëse jeni duke punuar për të arritur afatet tani, ju duhet ta zhvendosni fokusin tuaj larg ideve emocionale dhe drejt të menduarit analitik.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Jeta juaj ka qenë e qetë kohët e fundit, por rezultati se nuk është saktësisht ajo që keni dashur, në fund të fundit! Disa nga të lindurit në shenjë tuaj kërkojnë disa aventura, madje edhe dramë në të cilën mund të zhyten plotësisht.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Mos lejoni që arroganca e dikujt tjetër të futet nën lëkurën tuaj sot sepse nuk do t'ju ndihmojë për asgjë. Ju do të zhgënjeheni, por ata do të mbeten të lumtur, të paditur dhe bezdisës. Në vend që të reagoni negativisht, përdorni sensin tuaj të humorit.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Jeni një perfeksionist i pandreqshëm! Ju mund të identifikoheni duke qenë të pakënaqur në veten tuaj, por kjo nuk ju ndihmon ta kaloni ditën pa stres. Sot mund të jetë një ditë e mirë si në profesion ashtu edhe në dashuri.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> A po ndiheni shumë të kufizuar nga një marrëdhënie? A mendoni se po mbyteni nga ky person? Para se të ndiqni dëshirën e brendshme për të ikur prej tyre, ndaloni! Ju duhet të mendoni plotësisht të gjitha opsionet përpara se të veproni sot.</p>	 <p><b>UJORI</b> Si mund të largoheni nga gabimet e së kaluarës kur nuk doni që t'i harroni ato? Ju jeni një person i mrekullueshëm, por jo i përsosur, sepse askush nuk është i tillë. Kështu që jepini vetes një përqafim emocional sot dhe shikoni përpara.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Energjia juaj do të lulëzojë më së miri në një mjedis më të qetë, ku ju jeni vetëm ose shoqëroheni vetëm nga një ose dy persona të tjerë, mundësia për të realizuar planet tuaja është më e madhe. Kjo është një ditë e mrekullueshme për të nisur një investim.</p>

## Fustani ikonik i Princeshë Dianës del në ankand



**F**ustani i famshëm i Princeshë Dianës, që mbante veshur kur kërceu me John Travoltën në Shtëpinë e Bardhë, është nxjerrë në shitje për 350 000 paund. Princesha e Uellsit i la të gjithë pa mend kur veshi fustanin e mbrëmjes blu kadife në darkën shtetërore në vitin

1985. Pamjet e saj të vallëzimit u bënë virale në gjithë botë, ndërsa aktori e përshkroi si "një përrallë". Fustani do të dalë në ankandin Kerry Taylor Auctions në Londër më 9 dhjetor dhe konsiderohet një nga veshjet më ikonike të princeshës britanike.

## Serena Williamsi kujton ditën kur u martua



**T**enistja e njohur Serena Williams të dielën ka festuar dyvjetorin e martesës. Ajo e kujtoi këtë përvjetor me anë të një postimi në

rrjetin social "Instagram". "Dy vjet dhe duke numëruar... alexisohanian është akoma duke u bërë me mua", ka shkruar Williamsi.



## Beyoncé jua merr mendjen dhe sytë me këto fotografi

**A**jo di shumë mirë si ta tërheqë vëmendjen. Beyoncé të shtunën gjatë natës së dytë të Fondacionit Sean Carter të burrit të saj Jay Z në Hollywood në Florida bëri që të gjithë njerëzit t'i kthejnë sytë kah ajo. 38-vjeçaria

u shfaq me një fustan të argjendtë dhe me flokët e lëshuara. Kjo bamirësi kishte për qëllim mbledhjen e fondeve për t'i ndihmuar studentët e privuar nga shkolla dhe të kenë suksese në kolegje dhe universitete.

## Ariana Grande ka probleme me frymëmarrjen




**A**riana Grande ka folur për gjendjen aktuale të shëndetit të vet. Këngëtarja ka pohuar se ajo ka shumë dhimbje dhe ka paralajmëruar se duhet ta anulojë një koncert. "Mund të këndo, por kam dhimbje dhe vështirësi kur

marr frymë gjatë koncertit. Po takohem me doktorin tim dhe po përpiqem të bëj më të mirën për t'u përmirësuar. Gjëja e fundit që do të doja të bëja është të anuloja një koncert, por jam e detyruar", ka thënë ajo.

(Tregim)

# Ftesa të tepërta



DINO BUZZATI

Do të doja që ju të vini tek unë në një mbrëmje dimri dhe, duke u shtrënguar pas dritareve, të vëzhgojmë vetminë e rrugëve të errëta dhe të ngrira, të kujtojmë dimrat e përrallave, ku i përjetuam së bashku pa i ndier. Në fakt, kemi shtegëtuar në të njëjta rrugë zanash, unë, me hapa të ndrojtur, dhe, kaluam së bashku nëpër pyjet plotë me ujçer, dhe të njëjtët syshë na spiunuan nga tufat e myshkut të pezulluara (ngjitura) nga kullat, e mes fluturimit të kobrave. Së bashku, pa e ditur atë, që nga aty, mbase të dy vështruam drejt jetës misterioze, tek ishte duke na pritur. Atje ndjeheshin për herë të parë dëshirat tona të çmendura dhe të buta. "A të kujtohet?" tek i thamë njëri-tjetrit, duke u shtrënguar (përçafuar) butësisht, në dhomën e ngrohtë dhe ti më buzëqeshje e mbrojtur ndërsa jemi jashtë tingullit të çarçafëve të shkundur nga era. Por unë tani kujtoj – që nuk i dije përrallat antike të mbretërve pa emër, të bishave dhe kopshtet e përumbura. Por do të kaloje e rrëmbyer, nën pemët magjike që flasin me zë njerëzor, dhe nuk ke goditur ndonjëherë në derën e kështjellës së shkretë, as nuk ke ecur drejt dritës shumë larg natës, as nuk ke fjetur nën yjet e Lindjes, djepur nga një barkë e shenjtë.

Prapa dritareve, në mbrëmjen e dimrit, me siguri do të heshtim, unë do të humbas veten në përralla të vdekura, teksa ti do të përkujde-

sesh për të tjera gjëra të panjohura për mua. Unë do të pyesja "Atë kujtohet", por nuk do të kujtoni kurrë më.

Do të doja të ecja me ju, në një ditë pranvere, me qiellin gri dhe akoma me disa gjethe të vjetra të vitit të shkuar të zvarritura nëpër rrugë nga era, nëpër lagjet e periferisë dhe se ishte e diel. Në këto rrugëza shpesh lindin mendime melankolike dhe të çmuara, dhe në orë të tëra, poezia endet, duke u bashkuar me zemrat e atyre që e duan njëri-tjetrin. Lindin shpresat që ne nuk dimë si të themi, të favorizuar nga horizontet e tmerrshme prapa shtëpive, nga trenat që rrëshqasin, nga retë veriore. Dhe dorë më dorë ne do të ecim me hap të lehtë, duke thënë gjëra të pakuptimta, marrëzitë dhe ato më të dashurat.

Përderisa dritat e rrugës të ndriçohen nga shtëpitë e çoroditur, do të dalin historitë e këqija të qytetit, aventurat, romanet e dëshiruar. Dhe atehërë ne do të heshtim duke u mbajtur dorë më dorë teksa shpirtrat do të flasin me njëri-tjetrin pa thënë grimë fjalë (pa u ndier). Por ti – tani mbaj mend – që kurrë nuk më keni thënë gjëra të marrëzishme, budalleqe dhe të çmuara.

Kështu që ti nuk i ke dashur kurrë ato të Diela që unë po them dhe as shpirti juaj nuk mund të më flasë me timin në heshtje, dhe as nuk e njeh magjinë e qytetit të asaj kohe, as shpresat që zbresin nga veriu. Ju preferoni dritat, turmën, burrat që ju joshin, rrugët ku ata thonë se mund të takoni fatin. Ti je ndryshe

nga unë dhe nëse keni ardhur atë ditë për të shëtitur, je ankuar që jeni lodhur, vetëm kjo dhe asgjë tjetër.

Do të doja gjithashtu të shkoja me ju gjatë verës në një luginë të vetmuar, duke qeshur vazhdimisht për gjërat më të thjeshta, për të eksploruar sekretet e pyjeve, të rrugëve të bardha, në veçanti të disa shtëpive të braktisura. Ndaloni në urën prej druri duke vështruar ujin të kalojë, duke dëgjuar linjat telegrafike atë histori të pafundme që vjen nga fundi i botës dhe kush e di se ku do të përfundoj. Dhe, duke shkullur lulet e livadheve këtu, të shtrirë në bar, nën heshtjen e diellit, mendoni për humnerën e qiellit dhe retë e bardha ndërsa kalojnë nëpër majat e maleve. Ti do të klithje "Sa bukur!".

Asgjë tjetër nuk do të thonit sepse do të ishim të lumtur, trupat tanë duke u humbur në peshën e viteve, shpirtrat që ndihen të freskët (ringjallur), sikur të kishin lindur atëherë.

Por ju – kur mendoj për këtë – do të shikonit përreth pa e kuptuar, kam frikë dhe do të ndalonit duke u shqetësuar për të ekzaminuar një çorape, do të më kërkoni një cigare tjetër, me padurimin për t'u rikthyer ... Dhe nuk do të thonit "Sa mirë!", por ndonjëherë gjëra të varfëra për të cilat nuk më interesojnë. Sepse për fat të keq jeni e gatuar kështu. Dhe ne nuk do të ishim të lumtur as një grim. Unë gjithashtu do të doja – më lejoni të them – Do të doja t'ju përçafoja ndër krahët e mi nëpër

rrugët e mëdha të qytetit në një muzg të nëntorit, kur qielli është kristal i pastër. Kur fantazitë e jetës vrapojnë mbi kupolat dhe prekin njerëzit shpirtëlligë, në fund të gropës së rrugës, tashmë plot me ankth. Kur kujtimet për epoka të lumtura dhe gjurmët e lumtura kalojnë mbi tokë, duke lënë pas tyre një lloj muzike. Si fëmijë të pafajshëm krenar do të shikojmë fytyrat e të tjerëve, mijëra e mijëra, të cilët kalojnë kohën e tyre me hallet e njerëzisë.

Ne do të dërgojmë pa e ditur askush dritën e gëzimit dhe të gjithë do të detyrohen të na vështrojnë, jo nga zilia dhe keqdashja, por përkundrazi duke buzëqeshur sadopak me mirësi, për shkak të mbrëmjes që shëron dobësitë e njeriut. Por ti – e kuptoj këtë – në vend që të shikoni qiellin e kristaltë dhe aeroplanët e kolonaduar të rrahur nga dielli ekstrem, do të dëshironi të ndaloni dhe shikoni vetrinat e dyqaneve, arin, pasuritë, mëndafshët, ato gjëra të kota. Dhe nuk do të vini re fantazmat, as prezencat që kalojnë, dhe as nuk do të ndjeheni, si unë, fatin e merituar. As nuk do të dëgjonit atë lloj muzike, as nuk do ta kuptonit përse njerëzit na shikojnë me zili. Do të mendonit për të nersmen e varfër dhe e kotë që mbi ju statujat e arta do të ngrenë shpatat e tyre deri në rrezet e fundit. Dhe, unë do të jem vetëm. Është e panevojshme. Ndoshta të gjitha këto janë marrëzi, dhe ju ndoshta jeni më e mirë se unë, duke mos supozuar (pretenduar) aq shumë nga jeta. Ndoshta keni

të drejtë dhe do të ishte marrëzi të provoni. Por të paktën, këtë të paktën, unë do të doja të të shihja. Të ndodh çfarë të ndodh një farë mënyre do të gjejmë lumturinë. Nuk ka rëndësi nëse është ditë ose natë, verë apo vjeshtë, mjafton në një vend të panjohur, në një shtëpi të çorganizuar, në një han të egër. Do të më mjaftonte të jem pranë jush.

Unë nuk do të jem këtu për të dëgjuar – ju premtoj – as kërcitjen misterioze të çatisë, as nuk do t'i shikoj retë, as nuk do ta dëgjoj muzikën ose erën. Unë do të shmang këto gjëra të padobishme, të cilat i dua. Do të kem durim për gjërat e mia që nuk kupton, nëse ankoheni për rrobat e vjetra dhe paratë. Jo nuk do të jetë më poezia, as shpresat e zakonshme, aq miqësore për dashurinë. Mjafton që unë do t'ju kem pranë meje. Dhe do shohësh që do të kemi sukses, do të jeni mjaft të lumtur, me shumë thjeshtësi, vetëm burrë dhe grua, siç ndodh zakonisht në çdo skaj të botës.

Por ti – tani që mendoj për këtë – jeni shumë larg, qindra e qindra kilometra të vështira për t'u kapërcyer. Jeni brenda një jete që unë nuk e di, dhe të tjerw burrat janë pranë jush, të cilëve ju ndoshta u buzëqeshni, si mua në kohë të shkuar, ju desh pak kohë që të më harroni. Ndoshta nuk mund të mbani mend as emrin tim. Unë tani kam dalë nga jeta juaj, i hutuar nëpër mesin e hijeve të panumërta. Megjithatë mendoj gjithëmonë për ju, dhe më pëlqen t'ju them këto gjëra. /mapo



POEZI NGA FRANCESCA GALLELLO

# Tingujt e një rrjedhe që lanë shenja

Francesca Gallelo ka lindur në Cirò Marina ( KR) të Kalabrisë në Itali. Francesca është shkrimtare romanciere, poete, gazetare, historiane e periudhës së Rilindjes dhe e dialektit kalabrez. Presidente dhe themeluese e Shoqatës "RADICI", shoqatë për emancipimin shoqëror dhe politik të jugut të Italisë. Presidente dhe themeluese e Shoqatës "VELIERO", shoqatë letrare dhe kinematografike.

Poezitë e Francesca Gallelo janë redaktuar nga Dante Maffia, kandidat për çmimin "Nobel" në letërsi. Shpirti i saj revolucionar shprehet në disa nga poezitë e saj, ku trajton çlirimin shoqëror. Francesca Gallelo është konsideruar një revolucionare romantike e angazhuar për respektimin e dinjitetit të popullit të jugut të Italisë, di dhe për emancipimin e grave, luftëtare për të drejtat e grave



në botë. Ajo organizon sesione shkencore dhe konferenca në të gjithë Italinë. Francesca është drejtore e revistës online "RADICIinforma", si dhe shkruan për gazetën provinciale "Il Crotonese" dhe për revistën kombëtare italiane "Albatros". Fituese e disa çmimeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

## TAKIM

*Shpirti i vetmuar përkëdhel mendimin imagjinat të takimit, duart e nxehta tërheqin trupin e pangopur si ujë, etje dhe emocion nga ndjenjat e pashuara të puthjes së gojës sate të uritur.  
Kujdes psherëtimat!  
Trupat i duan rrobat,  
goja e pangopur mbi trupin e djersitur,  
në dridhjen e dashurisë zbulon si një ishull i ri çdo breg,  
e gjen të cflitur parajsën dhe e gëzon,  
duke braktisur me emocion një pëshpëritje,  
e si luftëtar tani pushon mbi trupin e djersitur të një dashurie të ngopur.*

## AH, NËSE MUND TË KTHEHEM PRAPA!

*Ah, në qoftë se unë mund të kthehem prapa,  
sa shumë gjëra do të ndryshojnë në ardhjen time mbi tokë.  
Duke parë këto duar plot me plagë dhe kallo të zeza,  
sa shkelma shpinës do t'u jepja qenëve të pronarëve,  
gjakun ma kanë thithur duke punuar në token,  
që ka pirë prej meje lotë dhe djersë.  
Sa herë që mendoj për gruan time të dobët,  
edhe ajo mendon,  
është lodhur dhe lodhjen ia hodhi gjakut,  
ndonjëherë e menduar pranë zjarrit.  
Më vjen një zemërim i fortë që ma ndez fytyrën,  
Sa? Po, -i thashë, ndërsa shpirti bërtiti:  
Bërtiti "Jo".  
Sa shumë "Jo", -i thashë, ndërsa shpirti bërtiti "Po".  
Unë po mendoj për gomarin tim të varfër.  
Pasuria ime e vetme është përkulja e kokës,  
kurrë nuk thashë një fjalë të keqe,  
kurrë nuk jam rrahur me nervat,  
bosi bëhet i keq dhe unë nuk kam kohë  
për tu bërë bos i keq.  
Shumë shpejt më duhet të përvesh mëngët,  
u ngrita shumë herët,  
për të sjellë një copë bukë mbi tryezë.  
Për t'u bërë bos nuk mjaftojnë toka dhe paratë,  
duhet kohë.  
Duhet kohë që të mësosh frustrimin e të ngjashëmve tuaj,  
duhet kohë që të mësosh si derdhet gjaku,  
duhet kohë që të mësosh të qeshurën me zë të lartë,  
në pikën që dridh tokën,  
për vdekjen e një aventurieri të varfër,  
një rënie nga lodhja dhe agjërimi.  
Duhet kohë për të mësuar si ndizet cigarja ngadalë-  
ngadalë.  
Ndërsa një baba i varfër i familjes,  
duke shikuar shtërngon kapakun në duar,  
ai pret leje për të marrë katër kokrra ullinjësh,  
që t'i çojë në shtëpi për të ngopur familjen,  
nga ullinjët që kanë rënë në tokë,  
nga pema kurrë nuk do t'i lejohej t'i kërkonte.  
Duhet kohë që të mësojmë si frustrohet një djalë i varfër,  
që është lejuar të pi një pikë verë,  
jo nga dëshira, por nga nevoja e djersitjes.  
Duhet kohë për të mësuar marrjen e goditjeve  
nga njerëzit më të mëdhenj se ti,  
njerëzve të krrusur nga lodhja dhe respekti,  
nga respekti, po nga respekti,  
për ta mësuar këtë fjalë nuk duhet kohë,  
mjafton që nëna dhe babai ta tregojnë me shembuj.  
Po të mundim të kthehemi prapa në kohë,  
në mësim dhe edukim një gjë do të ndryshoja,  
do të doja të forcoj qafën që mos ta ul kokën.  
Nëse do të kthehesha prapa në kohë,  
do të bleja një nerv të ndritshëm plot me dhjamë derri.  
Do t'u jepja frustrim të gjithë njerëzve dhunues.  
Frustroni njerëzit që kanë shumë kohë,  
frustroni për çlirimin e dinjitetit që shumë herë e keni  
përmendur,  
"si të doni Ju!", "si të thoni Ju!", "si të urdhëroni Ju!"*

## DO TË DOJA TË JAP...

*Do të doja të jap...,  
Deti do të donte t'u jepte anijet dhe fantazmat dashamirëse,  
valët dhe humnerat e krijimit dhe misterin e tij, këngët e sirenës në dashuri,  
algat e tij sfungjerore, lulet e tij në valëzim misterioz që thirrin valët si krahë.  
Pafundësinë do të doja t'ua jepja, fluturimin e një shqiponje reale,  
tingujt e një rrjedhe që lanë shenjat e një pejsazhi të ngadaltë e të lodhur,  
tastjerat e një pianoje, telat e një violine, melodinë e pashprehur dhe të padëgjuar,  
nxehtësinë e një shalli të vjetër, buzëqeshjen deriiii në një pëshpëritje,  
një flakë që vallëzon në mes të blusë dhe portokalles, ulërimë e një motori,  
aromë e një shege, veli i butë që bashkohet e përqafton detin dhe qiellin.  
Sa psherëtimë e gjatë pa frymë, plot dashuri konkurruese... paguar në kënaqësi.  
Goja paksa e hapur dhe mishtore, ende mban aromë puthjesh dhe mishi të djersitur,  
çfarë goditje e fortë e bën të vallëzojë gjoksin dhe këto krahë të pafuqishëm,  
se përmes lirit të qëndisur pushojnë dashuritë e ushqyera...  
Çfarë të them... "pastaj" ..., boshësia dhe plotësia e një ikje dhe kthimi... e një ti që të përket  
liria,  
ajo shkallë që ngjitet drejt qiellit, ajo lule, vendosur buzë një gremine,  
ajo shembja ime në ty, ku në thellësi të mishit tënd gjej paqen time.*

## KUR DASHURIA

*Kur dashuria të lë dhe jeni duke u plakur, si dielli që çliron ujin në kokën tënde,  
në këtë përzierje mendimesh, çfarë?  
Të bëjnë të humbësh shikimin nga sytë, të trazohet zemra që rreh muret e shpirtit tim,  
si një ujk që merr uri prej teje dhe bëhet një ndëshkim, çfarë?  
Duket një ujk i uritur dhe i pikëlluar, koka dhe mendimet kërkojnë fjalë,  
fakte dhe sjellje, si në një film rrëshqasin njëri pas tjetrit.  
Po, përse e kam bërë? Cila është fjala e keqe që thashë? Cila? Sjellja ime e keqe?  
Shkoj duke u endur rrugëve si një i dehur, duke u përplasur nga njëri mur te tjetri,  
një hap i shpejtë, një nëpërkë helmuese më ngjitet shpinës deri në kokë.  
Një vajzë cigane më terheq dhe merr dorën time mbi të sajën,  
don të lexojë çfarë unë kam në zemër,  
ke një faturë që vetëm unë mund t'ua shlyej,  
qëndro mbi këtë hap që unë të vij e ta marr me të shpejtë.  
Tërhiq krahun, shko e më le vetëm, nuk duhet të më thuash çfarë kam në zemër,  
nuk di të lexoj, kuptoj vetëm mendimet e zemrës sime,  
janë fjalët e vetme që di të lexoj duke zvarritur shpirtin.  
Më lajmërojnë drejt tokës së strëgjyshit tim,  
më lënë nën drurin e ullirit, ku tërheq këmbën deri në zemër,  
duke kërkuar nxehtësinë që vetëm zjarri mund të ma japë.  
Kam rënë në gjumë me diellin dhe nën një mantel të ndritshëm u zgjova,  
sa të bukur janë këto yje në qiell, si lule do të doja t'i mblidhja,  
një shportë plot për ty do të sillja, dobësia ime,  
për të ndriçuar zemrën dhe lexuar mendimet e tua,  
ku do të më pëlqente të ishte shkruar një fjalë për mua,  
një fjalëz e ëmbël si mjalti, e trëndafiltë si zjarri,  
që lëshon fishekzjarre në fytyrën time, kur të shoh.  
E pabesë, më ke lënë vetëm në këtë flakë,  
ku piqem dhimbshëm, pa dashur të ikë,  
nuk dua të harroj zjarrin as dhimbjen që ndjej për ty,  
nuk dua t'i lë, sepse kjo dhimbje është gjëja e vetme që më mbeti prej teje.*

*Përkthyer nga italishtja : Mapo/Nikollë Loka.*

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

## Eliminatorët të suksesshme, kualifikimi në mars

Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi dhe ish-reprezentuesi e tash analisti i futbollit, Genc Sermaxhaj kanë dhënë vlerësimet maksimale për performancën e treguar nga "dardanët" në eliminatorët për Kampionatin Evropian. Ata besojnë se Kosova në "Euro 2020" do të kualifikohet në muajin mars nëpërmjet Ligës së Kombeve. Siç dihet Kosova në gjysmëfinale takohet me Maqedoninë e Veriut në Shkup dhe nëse arrijnë fitore në finale përballet me fituesin e ndeshjes Bjellorusi-Gjeorgji



shumë cilësi. Kryetari Ademi, ka thënë se "dardanët" kualifikimin do ta kërkojnë nëpërmjet Ligës së Kombeve. "Tani i gjithë përqendrimi ynë bartet te 'play-off'-i Ligës së Kombeve, aty, ku e kemi mundësinë tjetër për ta jetësuar ëndrrën. Uroj që futbollistët tanë gjatë kësaj periudhe të kenë shëndet dhe formë të mirë dhe në muajin mars të jemi të kompletuar për ndeshjen gjysmëfinale kundër Maqedonisë së Veriut. Kam besim të plotë se ky angazhim dhe entuziazëm në fund do të na shpërblehet me kualifikim në Evropian", ka shtuar Ademi. Paraqitjet e Kosovës i ka komentuar dhe analisti dhe trajneri i futbollit Genc Sermaxha. Ky i fundit ka thënë për gazetë se "Dardanët" kanë bërë paraqitje të dinjitetshme përgjatë kualifikimeve, kurse është i bindur se do të kualifikohen në Kampionatin Evropian nëpërmjet Ligës së Kombeve. "Kosova bëri paraqitje të dinjitetshme si vendas, por edhe si mysafir, duke ju treguar të gjithëve se për vetëm

pak vite kemi arritur të krijojmë një përfaqësuese shumë të fuqishme me lojtarë të rinj e mjaftë cilësore. Në dy ndeshjeve e fundit ndaj Çekisë dhe Anglisë nuk kemi bërë lojë të mirë e as nuk kemi arritur rezultat pozitiv, por shpresoj që të jemi të vetëdijësuar dhe mos të bëjmë gabime për ndeshjet e marsit në Ligen e Kombeve, ku kemi mundësi të fundit dhe shumë të mirë që edhe ne të kapim trenin e fundit për Evropian", ka thënë Sermaxhaj. "Këto eliminatorë ishin promovim shumë i mirë i vendit tonë, sidomos mirëpritja ndaj anglezëve që ua bëmë, por edhe paraqitjet tona ndaj kundërshtarëve të forte si Çekia e Anglia na kanë forcuar e na kanë dhënë përvojë të mirë që eventet tjera më rëndësi të dimë si t'i qasemi. Duke parë moshën e lojtarëve dhe cilësinë kemi mundësi të kualifikohem, sepse jemi më të mirë se kundërshtarët që na presin", ka deklaruar Sermaxhaj. Ish-reprezentuesi i Kosovës e lavdëroi edhe një herë tjetër përzgjedhësin Bernard Challandes. "Çelësi i këtij suksesi është padyshim trajneri Challandes, sepse me përvojën

dhe njohuritë që ai ka për lojën e futbollit, ka arritur të nxjerr maksimumin nga këta lojtarë që ne kemi aktualisht", ka përfunduar Sermaxhaj.

### REZULTATET E KOSOVËS

Kosova-Bullgaria	1-1
Mali i Zi-Kosova	1-1
Bullgaria-Kosova	2-3
Kosova-Çekia	2-1
Anglia-Kosova	5-3
Kosova-Mali i Zi	2-0
Çekia-Kosova	2-1
Kosova-Anglia	0-4

## Anglia falënderon Kosovën për mikpritjen

LONDËR, 18 NËNTOR - Kombëtarja e Anglisë e ka falënderuar Kosovën publikisht për mikpritjen e ngrohtë që ua ka bërë lojtarëve dhe tifozëve të saj gjatë vizitës në Prishtinë për ndeshjen përmblylëse për kualifikimet në "Euro 2020". Kosova e mahniti botën me mënyrën se si e priti Anglinë në Prishtinë, si shenjë falënderimi dhe mirënjohje për ndihmën dhe kontributin që Britania e Madhe ka dhënë në çlirimin dhe pavarësimin e vendit më të ri në Evropë. Nga tifozët, lojtarët, stafi dhe trajneri, të gjithë në kampin anglez kanë mbetur gojëhapur me pritjen që u është ofruar nga kosovarët. Madje mediat botërore e kanë marrë



Kosovën si shembull se si duhet të pritet një ekip vizitor në futboll. Kombëtarja e Anglisë ka falënderuar "dardanët" për mikpritjen pas mbërritjes në

ishull përmes një postimi në "Twitter". "Çfarë mikpritje! Faleminderit Kosovë!", shkruan në postim, ku kanë postuar edhe disa fotografi të ndeshjes.

EPOKA ERE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 17 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll i mbylli në pozitën e tretë me 11 pikë të grumbulluara kualifikimet për kampionatin Evropian "Euro 2020". Pavarësisht faktit se "dardanët" dështuan të kualifikohen, kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka thënë se cikli kualifikues ishte i suksesshëm për Kosovën, e cila ka lënë gjurmë të pashlyeshme në eliminatorë dhe se progresi i saj po vlerësohet nga të gjithë. "E përmbyllëm një tjetër cikël të garave duke lënë gjurmë të pashlyeshme. Progresi ynë po vlerësohet nga të gjithë. Pas suksesit në Ligën e Kombeve, ne bëmë paraqitje mahnitëse edhe në ciklin kualifikues për Euro 2020, duke bërë krenar tërë kombin dhe duke e lartësuar shtetin kudo ku jemi paraqitur", ka thënë Ademi, i cili shtoi se nuk është skuadër e re përfaqësuese të arkëtosh 11 pikë në një grup me kombëtare me shumë traditë dhe

## Rrethi i dytë i Kupës sjell dy derbi

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Shorti për rrethin e dytë të DigitAlb Kupës së Kosovës në futboll është hedhur të hënën, derisa ky rreth ka sjellë dy përballje derbi. Fituesi në fuqi i Kupës, Feronikeli, do të përballet në Drenas me skuadrën e Llapit që, po ashtu, ka synim të mëdha për të dalë në Evropë. Derbi i dytë i kësaj faze do të zhvillohet në Suharekë, Ballkani e pret skuadrën e Dritës nga Gjilani. Ndeshjet e këtij rrethi zhvillohen më 27 nëntor nga ora 12:30. Çiftet e rrethit të dytë: 2 Korriku-Istogu, Dukagjini-Besa, Vëllaznimi-Ferizaj, Arbëria-Onix,



Vitia-Ramiz Sadiku, Ulpiana-Liria, Malisheva-Gjilani, Feronikeli-Llapi, Dardana-Vllaznia, Ballkani-Drita, Dardanët-Trepça '89, Flamurtari-Vushtrria, Minatori-Prishtina, Drenica-Fushë Kosova, Trepça-Drenasi, A&N-KEK-u.

## KOK-u, anëtar i 121-të i FICTS

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Komiteti Olimpik i Kosovës është bërë anëtar i 121-të i Federatës Ndërkombëtare për Kinemanë Televizive Sportive (FICTS). Vendimi i marrë nga Komiteti Ekzekutiv i FICTS i është dërguar kryetarit të KOK-it, Besim

Hasani. Njohja e KOK-it në FICTS vjen pas takimit të presidentit Hasani me presidentin e FICTS, Franco Ascani, gjatë Festivalit të 37-të të FICTS "Sports Movies & TV", që u mbajt në fund të muajit të kaluar në Milano të Italisë.

"Kryetari Hasani e ka vlerësuar lart anëtarësimin në FICTS, i cili tani ia hap dyert edhe Kosovës, e cila që nga viti i ardhshëm do ta organizojë Festivalin e Filmit Sportiv në Kosovë, ndërsa filmat më të mirë të zhanreve të ndryshme

të zgjedhur në Festivalin e Kosovës nga juria profesionale do të marrin pjesë në Kampionatin Ndërkombëtar të FICTS, që do të mbahet për herë të 38 në Milano të Italisë, në nëntorin e vitit 2020", thuhet në njoftimin e KOK-it.



## Greзда: Unë nuk jam Balotelli

TIRANË, 18 NËNTOR - Eros Grezda ishte një nga mungesat më të rëndësishme të kombëtares shqiptare në ndeshjet e fundit kualifikuese për "Euro 2020". Futbollisti duket se ka pasur një përplasje me trajnerin Edi Reja, të cilën e pohoi edhe në "Ora Sport". Gjithashtu, lojtari i Rangersit konfirmoi që në verë ishte shumë pranë kalimit në kampionatin francez, te Brest. "Kanë ndodhur gjëra në karrierën time që nuk më lejuan të jem në këtë grup. Italishten nuk është se e di mirë. Atë që e ka thënë trajneri nuk e kam marrë mirë, por nga ato që tha për kthyesin dhe portalet, kam shkruar atë status. Unë nuk kam marrë asnjë ftesë. Nga ai incident në qershor nuk kam marrë ftesë nga kombëtarja. Nuk kam marrë asnjë kontakt të vogël. Më shumë problem mund ta quaj se nuk po luaj me klubin pasi, nëse luaj mirë me klubin, nuk besoj se do të mungojë ftesa", ka thënë Grezda. "Unë do t'ia lija më shumë fajin, që nuk kam minuta te Rangersi, trajnerit të kombëtares. Është skuadra e lojtarëve që nuk lua-



jnë. Kam bërë maksimumin dhe kjo është reflektuar edhe në javët e fundit. Duhet të jem i koncentruar për të arritur sa më mirë. Më intereson më shumë një ekip i fortë. Erdhi një ofertë zyrtare nga Bresti. Unë e kisha qejfin që të shkoja atje sepse ishte shumë i interesuar për

mua, diçka që më mërziti mua dhe njëkohësisht më penalizoi. Grezda nuk është Balotelli. Të gjithë ata që më njohin e dinë mirë kush është Grezda. Nuk kam bërë kurrë fjalë me Gerrardin, por me Rejen ishte një gjë komplet ndryshe", ka shtuar Grezda.

## Lakersat nuk ndalen në Perëndim

LOS ANGELES, 18 NËNTOR - Vizion momenti i mirë në kampionat i LA Lakersit, që fitoi 122-101 ndaj Atlantës, duke kryesuar renditjen në Konferencën e Perëndimit. Ndeshje e dominuar nga ekipi kalifornian, ku u dallua LeBron Jamesi me 34 pikë e 12 asistime. Po në Perëndim, në fund të renditjes ndodhet skuadra e Golden States, që u mund 108-100 nga New Orleansi. Nënkampionët e NBA-s vazhdojnë ta vuajnë mungesën e titullarëve (Paschall 30 pikë), ndërkohë që për vendësit u dalluan Reddick me 26 pikë e Holiday me 22 pikë. Fitore në frymën e fundit arriti skuadra e



Sacramentos, që mposhti me rezultat 100-99 Bostonin, takim me shumë veprim në sekondat e fundit. Për vendësit u dallua Hield me 35 pikë, lider në fushë, ndërsa te Celticsi mungoi lojtari lider. Me lehtësi fitoi edhe ekipi i Denverit, që mundi 131-114 Memphisin.

Për miqtë u dallua Murray, autor i 39 pikëve, mbështetur edhe nga Millsap me 23. Fiton edhe Orlando, 125-121 ndaj Washingtonit (Vuqeviq 30 pikë e 17 rebound), ndërsa Philadelphia triumfoi 114-95 ndaj Clevelandit (Harris 27 pikë).

### SHKURT

#### Fenerbahçe nuk e shet Muriqin në janar

Fenerbahçe ka vendosur të mos e shesë sulmuesin Vedat Muriqi gjatë afatit kalimtar të janarit. Sipas medieve turke, Fenerbahçe dëshiron ta mbajë në skuadër sulmuesin deri verën e ardhshme pasi beson se deri atëherë vlera e tij do të rritet dhe lojtari mund të shitet deri në 20 milionë euro. Muriqi është duke vuajtur nga një lëndim në këmbë gjë që ka bërë të mos luajë në dy ndeshjet e fundit për Kosovën. Disa prej klubeve të mëdha evropiane si Napoli, Manchester Unitedi dhe Tottenham kanë shfaqur interesim për sulmuesin nga Kosova.

#### Reja, gati ta vazhdojë kontratën me Shqipërinë

Kombëtarja e Shqipërisë i mbylli kualifikimet për Kampionatin Evropian me humbjen nga Franca (0-2). Trajneri Edy Reja është i gatshëm të mbetet në krye të ekipit kuqezi edhe për një kohë të gjatë. "Do të flas me presidentin për të ardhmen time pasi kontrata ime përfundoi. Kemi bërë një punë të mirë dhe më ka pëlqyer. Do të doja të vazhdoja me Kombëtaren shqiptare", ka thënë Reja.

#### FSPK-ja organizon turne të basketbollit për Ditën e Flamurit

Në organizim të Federatës Sportive të Punëtorëve të Kosovës (FSPK) dhe në mbështetje të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) për nder të Ditës së Flamurit, në palestrën sportive "Don Bosko" në Prishtinë më 23 nëntor (e shtunë), me fillim nga ora 10:30, do të organizohet turneu i basketbollit në të dyja konkurrencat. Në këtë turne pritet të marrin pjesë një numër i madh i ekipeve që do të përfaqësojnë institucione dhe kompani të ndryshme nga Kosova. Ndërkaq edhe Federata e Basketbollit të Kosovës do të marrë pjesë me ekipet e saj në të dyja konkurrencat. Duhet theksuar se ditë më parë zyrtarët e të dy federatave janë takuar dhe kanë rënë dakord që FBK t'i asistojë FSPK-së në këtë turne, ndërsa në ditët në vazhdim do të mbahet një takim ku do të diskutohet riaktivizimi i Ligës së Basketbollit të Punëtorëve Sportivë të Kosovës.

#### Atleti kenian pezullohet katër vjet dhe i hiqet rekordi botëror

Atleti 30-vjeçar kenian Abraham Kiptum është dënuar me katër vjet përjashtim nga të gjitha aktivitetet sportive, pasi është konsideruar fajtor nga antidopingu britanik. Ai ka dalë pozitiv me substanca të ndaluara gjatë një testi antidoping. Edhe pse testi është kryer këtë vit (fillimisht u pezullua 30 ditë, në prill të këtij viti), dënimi do të përfshijë edhe rezultate që janë arritur në vitin 2018. Për pasojë, Kiptum i është hequr rekordi botëror që vendosi në garën e gjysmëmaratonës. Më 13 tetor 2018 keniani dha kohën 58'18" në garën e gjysmëmaratonës në Valencia, rekord botëror (përmirësoi me pesë sekonda kohën e mëparshme). Gjithsesi, kjo kohë tashmë nuk ekziston më. Dënimi për Abraham Kiptum do të përfundojë në mars të 2023-s.

#### Brazili, kampion i Botës për U17

Brazili është shpallur kampion i Botës në futboll për grupmoshën U17. Skuadra braziliane triumfoi në finalen e luajtur në shtëpinë e saj, duke mundur me përmbysje 2-1 Meksikën në një sfidë me të vërtetë të çmendur. Pavarësisht prej rasteve për shënim, pjesa e parë u mbyll me rrjeta të paprekura. Pas pushimit, meksikanët surprizuan organizatorët në minutën e 66, kur Gonzales shënoi golin e avantazhit. Zhgënjimi i tifozëve vendës mori formë dhe u bë i dukshëm me kalimin e minutave. Por në fundin e ndeshjes atmosfera ndryshoi krejtësisht. Në minutën e 83-të nga pika e 11-metërshave, Caio Jorge barazoi shifrat dhe ndezi sërish shpresat e "Selecao"-s. Kur pritej që ndeshja të shkonte në shtesë dhe ndoshta deri te goditja e penalltive, në minutën e 93-të, Lazaro shënoi golin e dytë dhe të fitores për Brazilin, që kthehet kampion i botës për 17-vjeçarët pas një mungese shumë të gjatë.

#### REZULTATET

Cleveland - Philadelphia	95-114
Sacramento - Boston	100-99
Memphis - Denver	114-131
Orlando - Washington	125-121
New Orleans - Golden State	108-100
Lakers - Atlanta	122-101



Republika e Kosovës  
Komuna e Malishevës



Drejtoria Për Arsim dhe Edukim

Nr: 11/2837  
Më: 18.11.2019

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), Neni 5 pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik Neni 4. Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 10/2018 datë: 20.07.2018 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm.

Drejtoria për Arsim dhe Edukim shpall:

## KONKURS

Për plotësimin e vendit të punës

Viti shkollor 2019/2020

Nr.	Niveli, Shkolla	Pozita	Vendi i lirë/zëvendësim	Numri i pozitave	orë
2	SHFMU" Kajtaz Ramadani" paralelja në Gullboc	Mësimdhënës i ciklit fillor	Zëvendësim	1	20

### I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal (letërnjoftimi ose pasaporta)
- Diplomat e kualifikimit (ose çertifikatat), çertifikatat në vend të diplomës jo më të vjetra se gjashtë muaj.
- Çertifikata që nuk jeni nën hetime
- Dëshmitë e përvojës në institucionet arsimore ( nëse ka)
- Çertifikata e lindjes

### II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar.

❖ **Kriteret e kualifikimit:** Për vendin e punës mësimdhënës të programit fillor kërkohet kualifikimet: **Fakulteti i Edukimit- programi fillor; Fakulteti i Mësuesisë** ashtu siç planifikohet me UA-ve të MASHT-it për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm Nr. 10/2018 datë 20.07.2018.

Vetëm në mungesë të kandidatëve nga sqarimi i lartcekur, do të shqyrtohen edhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim më të përafërt.

### III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuar dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ata që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi)

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kanë diplomat e nostrifikuara në MASHT.

### Për intervistë do të ftohën ata kandidatë, të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të cekura.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë dhe orari i intervistave publikohet në web- faqen e Komunës së Malishevës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

### Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më: **18.11.2019 më datën:02.12.2019**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes protokollit, përkatësisht përmes zyrës së pritjes së palëve, në objektin e ri të Komunës së Malishevës.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

KRYETARI I KOMUNËS

INr. 464-60849  
Datë: 18.11.2019

Në bazë të dispozitave të neneve 11,13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 datë 4 Qershor 2008, nenit 4, nenit 7 dhe nenit 8, paragrafi 5 të Ligjit Nr.03/L-139 Për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, dhe me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/1-205 datë 28 Tetor 2010, dispozitave të nenit 83 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 datë 25 Maj 2016, nenit 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit INr.110-623 datë 26.09.2008, Vendimit të Kuvendit Komunal Lipjan 15Nr.464-70930 datë 31.10.2019 për shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshmerive, Kryetari i Komunës së Lipjanit merr:

### VENDIM

I. Miratohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim shtesë për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga projekti për ndërtimin-asfaltimin e rrugëve "Bejtush Gërbeshi" dhe "Qamil Olluri" në Lipjan, sipas tabelave të përshkruara nga evidenca kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik, si dhe sipërfaqet e tyre të cilat tabela paraqesin pjesët përbërse të këtij vendimi.

II. Vlera e kompensimit të pronës caktohet nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës konform Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr.03/L-205 të datës 28 Tetor 2010 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 për miratimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit-Sektorit pronësoro-juridik, Drejtorati për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtorati i Shërbimeve Publike.

IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe publikimit të tij në njërin nga gazetat me tirazh më të madh.

Ë'u dërgohet:

- të gjitha Drejtorive
- Arhiv të Komunës

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

PRESDENNIK OPŠTINE

1Br.464-60849  
Dana: 18.11.2019

Na osnovi stavova člana 11,13 Zakona o Lokalnoj Samoupravi br.03/L-040, Službene Novine Republike Kosova, Br. 28 dt 4 Juni 2008, člana 4, člana 7 i člana 8, stav 5 zakona Br.03/L-139 Eksproprijaciju nepokretne Imovine, promene i dopune obavljene sa Zakonom Br.03/1-205 dt.28 Oktobar 2010, stavova člana 83 stavove člana 83 Zakona za Opštu Administrativno Proceduri Br.05/L-031 dt 25 Maj 2016, član 40 i 41 Statuta Opštine Lipljan 1Br.110-623 dt 26.09.2008, Odluke Skupštine Opštine Lipljan 15Br.464-70930 dana 31.10.2019 za objavljivanje javnog interesa za eksproprijaciju nekretnina, Predsednik Opštine Lipljan donosi:

### ODLUKA

I. Usvaja se daljna rasprava zahteva za dodatno eksproprijaciju za javni interes nepokretne imovine imanja i vlasnika interesa koje se dotiču od projekta izgradnje i asfaltiranje ulica "Bejtush Gërbeshi" i "Qamil Olluri" u Lipjan, prema tabelama opisane iz nadležne katastarske evidencije za titulara nepokretne imovine, njihovo pozicije u okviru projekta javnog interesa kao i njihovo površina tabele koje su deo ove Odluke.

II. Vrednost kompenzacije imovine se određuje od Kancelarije za Procenjivanje Nepokretne Imovine u Okviru Ministarstva Financije Republike Kosova u skladu sa Zakonom Br.03/L-139 za eksproprijaciju nepokretne imovine, sa dopunama i promenama obavljene u Zakonu br.03/L-205 dt 28 Oktobra 2010 i Administrativnog Upustva Br.02/2015 za usvajanje načina i kriterijumima tehničkih procenjivanja iznosa za nepokretnu imovinu i štete koje se stvaraju u ekproprijaciju.

III. Za sprovođenje ove Odluke: Kancelarija Predsednika –Pravno imovinski Sektor, Direktorat za Urbanizam Planiranje i Zaštite Sredine, Direktorat za Geodeziju i Katastar i Direktorat Javne Usluge.

IV. Odluka stupa na snazi dana objavljivanja u Službene Novine Republike Kosova i objavljivanje u nekoj novini sa velikim tiražom.

Dostaviti:

- Svim Direktoratima
- Arhivi Opštine

PRESDENNIK OPŠTINE  
Imri Ahmeti







REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

PRESDNIK OPŠTINE

OBAVEŠTENJE

Na osnovi stava 7.3 člana 8 Zakona Br.03/L-139 za eksproprijaciju nepokretne imovine sa promenama i dopunama obavljene sa Zakonom br.03/L-205 i Odluke predsednika Opštine 1Br.464-60849 dana 18.11.2019 obaveštavamo sve subjekte opisane u Odluci zajedno sa ovom odlukom sa Obaveštenjem:

1. Za postizanje javne namere za realizovanje Projekta Opštine Lipjan izgradnje i asfaltiranje ulica "Bejtush Gërbeshi" i "Qamil Olluri" u Lipjan, nakon ispunjavanja svih uslova u stavu 1 člana 4 Zakona Br.03/L-139 dt 26.03.2009 za Eksproprijaciju nepokretne imovine, sa promenama i dopunama u Zakonu br.03/L-205 dt 28.10.2010, u nastavku zahteva obavljenog od Direktora Javnih Usluga Opština u sprovođenje gorenavedenog zakona usvojila, Odluke Skupštine Opštine Lipjan 15Br.464-70930 dana 31.10.2019 za objavljivanje javnog interesa za eksproprijaciju nekretnina, sa kojim se usvaja dalje razmatranje zahteva za eksproprijaciju za javni interes za nepokretne imovine vlasnika i interesa koje se dotiču izgradnje i asfaltiranje ulica "Bejtush Gërbeshi" i "Qamil Olluri" u Lipjan, kadastralna Zona Lipjan, Banduliç i Gillogovce prema tabeli opisane iz katastralnih evidencijama za vlasnike nepokretni imaovina njihova pozicija u ukviru javne interesakai i njihova površina tabela je deo ovog Odluke.

2. Predsednik Opštine doneče Predhodnu Odluku u roku od 30- kalendarskih dana nakon ispunjavanja uslova određenih sa članom 9 Zakonom Br.03/L-139 dt 26.03.2009 za eksproprijaciju nepokretne imovine , sa dopunom i promenom obavljene u Zakonu br.03/L-205 dt 28.10.2010, oko organizovanja javnih debata.

3. Svako interesovana stranka ima prava da dostavlja pismena komentere oko predloženog eksproprijaciju od organa eksproprijacije u roku od 10 kalendarskih dana nakon objavljivanja Odluke Predsednika Opštine 1Br.464-60849 dana 18.11.2019, za usvajanje zahteva za eksproprijaciju dana objavljivanja u jednom novini sa najvećim tiražom na Kosovu.

4. Predsednik Opštine će održati janu debatu oko tražene eksproprijacije za realizovanje projekta Opštine Lipjan izgradnje i asfaltiranje ulica "Bejtush Gërbeshi" i "Qamil Olluri" u Lipjan.

5. Svi zainteresovana lica koji su službenici Opštine, u koju se održava javna debata ili vlasnici, interesovana lica koja se nalaze na ovom delu ili advokat ,predstavnik imaju pravo da učestvuju na javnu raspravu.

6. Svako interesovano lice daće mu se mogućnost da bi dao njegovo mišljenje usmeno oko eksproprijacije u skladu sa stavovima 2,3,4 član 9 të Zakona Br.03/L-139 dt 26.03.2009 za eksproprijaciju nepokretne imovine, sa dopunama i promenama obavljena sa Zakonom br.03/L-205 dt 28.10.2010.

7. Svako zainteresovano lice koji želi da učestvuje ili da svoje mišljenje u javnu debatu treba da dostavi sa sobom opravdane (dokumente) koje svedoče da je slušbeno Lice, vlasnik, ili avokat ili Zakonski Predstavnik tog slučbenog lica ,vlasnika ili drugih.

8. Javna rasprava oko predloženog eksproprijacije, prava vlasništva ili drugih prava u nepokretne imovine koje se nalaze unutar teritorijalne vlasništvo Opštine Lipjan će se održati **dana 27.11.2019 u 10<sup>00</sup>**, Objektu Opštine Lipjan - sala Skupštine.

9. U slučaju da imovina je objekat zahteva ,se eksproprijirane na osnovu procedure eksproprijacije inicirane u skladu sa tim zahtevom nijedno kompenzacija neće se isplatiti za troškove ili vrednost nekih popravki obavljeno u imovinu, građevinskih objekata ili proširenje objekata u imovinu, ili voča i ostalih biljka nasadenih nakon dana ispunjavanja stavova stava 8 člana 8 Zakona Br.03/L-139 za eksproprijaciju nepokretne imovine sa dopunama i promenama sa Zakonom br.03/L-205 dt 28 Oktobar 2010. Svako lice koje namerava da ima interes ili neki drugi interes na imovinu savetuje se da razmotri Zakon Br.03/L-139 dt 26.03.2009 za eksproprijaciju nepokretne imovine obavljene u Zakonu br.03/L-205 dt 28 Oktobar 2010, i da traži Pravnu pomoć da bi razumeo svoja Zakonska prava.

10. Svako lice koje nije imenovan sa obaveštenjem i da smatra da ima imovinski interes ili drugi u nekoj parceli nepokretne imovine opisane u Obaveštenju odmah treba da dostavi u Organu eksproprijacije jedno opisivanje njegove tvrdnje pravno osnovu tog tvrdjenja kao i kopije svakakvih dokumentacija koje je vezano sa tim tvrdnjem.

PRESDNIK OPŠTINE  
Imri Ahmeti



Detalni opis katastarskih parcela prema Certifikatima- kadastrske Jedinice

K.K. Lipjan Gjendja e vjetër					K.K. Lipjan Gjendja e re					
Br.	Vlasnik	Kadastralna parcela	Kultura-klasa	Površina m <sup>2</sup>	Vlasnik	Kadastralna parcela	Kultura-klasa	Ostatak Površine m <sup>2</sup>	Površina za Završnu Odluku 1Nr.464-23129/1 dt. 21.11.2018	Druga Površina za Put m <sup>2</sup>
1	Afrim Lekiqi (Mehdi)	1353 ZK Lpjan	Njiva kl.1	302	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	204	35	63
2	Afrim Lekiqi (Mehdi)	1354-2 ZK Lpjan	Njiva kl.1	168	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	129.14	14	25
3	Afrim Lekiqi (Mehdi)	1354-1 ZK Lpjan	Njiva kl.1	169	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	138	11	20
4	Remzi Haziri (Avdullah)	1355-0 ZK Lpjan	Njiva kl.1	825	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	718	33	74
5	Remzi Haziri (Avdullah)	1356 ZK Lpjan	Njiva kl.1	1038	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	964	15	59
6	Safet Bislimi	1358-1 ZK Lpjan	Njiva kl.4	2223	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	2120	21	82
7	Ekmir Bislimi (Rasim)	1358-11 ZK Lpjan		620	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	501	41	78
8	Tahir Jetullahu	1358-2 ZK Lpjan	Njiva kl.1	2000	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	1951	22	27
9	Luljeta Strelli Sabit Zogaj	1423-13 ZK Lpjan	Njiva kl.4	480	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	388	45	47
10	Skender Qerimi (Faik)	1423-4 ZK Lpjan		618	Dosadašnji Komuna e Lipjanit	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	602	8	8
11	Ramiz Qeriqi (Rexhep)	2031-1 ZK Lpjan		870	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	862	4	4
12	Hajrush Sopa (Brahim)	2031-10 ZK Lpjan	Njiva kl.2	479	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	441		38
13	Isa Qeriqi (Rexhep)	2034-1 ZK Lpjan	Njiva kl.1	515	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	453	24	38
14	Ramiz Qeriqi (Rexhep)	2034-9 ZK Lpjan		562	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	556	2	4
15	Ahmet Maksuti (Shaban)	1426-2 ZK Lpjan	Njiva kl.1	1172	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	1086	29	57
16	Ilir Zogaj (Isuf)	1427-3 ZK Lpjan	Njiva kl.1	328	Dosadašnji Gjerëtanishmi Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	281	17	30
17	Ilir Zogaj (Isuf)	1427-32 ZK Lpjan	Njiva kl.1	172	Dosadašnji Komuna e Lipjanit	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	147	9	16
18	Osman Maliqi (Bislimi)	1427-33 ZK Lpjan		1600	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	1582	7	11
19	Fatmir Zogaj (Jusuif)	1432-6 ZK Lpjan	Njiva kl.1	500	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	438	20	42
20	Besim Jashari	02208-1 ZK Lpjan	Njiva kl.1	3433	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	3420	3	10
21	Besim Jashari	1432-4 ZK Lpjan	Njiva kl.1	500	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	448	8	44
22	Emrush Salihi.Z Mehmedali Salihi (Osman)	00001-1 ZK Banullë	Njiva kl.3	16383	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	15840	34	509
23	Nazim Salihu	00001-2 ZK Banullë	Njiva kl.3	6685	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	6477	35	173
24	Rrahim Thaqi (Qerim)	00002-0 ZK Banullë	Njiva kl.3	4983	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	4814	70	99
25	Xhevdet Marevci (Izjadin)	00003-1 ZK Banullë	Njiva kl.3	1000	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	869	62	69
26	Brahimi Ramadani (Mustafë)	00003-4 ZK Banullë	put	510	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	490		20
27	Maliq Salihu (Ibish)	00004-0 ZK Banullë	Njiva kl.3	2964	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	2870	48	46
28	Ruzhdi Salihi (Shaban)	00005-0 ZK Banullë	Njiva kl.3	2812	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	2744	30	38
29	Nazim Salihi (E)	00006-0 ZK Banullë	Njiva kl.3	2997	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	2924	31	42
30	Enver Aliu (Agim)	00057-0 ZK Gillogovc	Njiva kl.3	4246	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	3749	261	236



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë/ Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku i Tehnologiju/ Ministry of Education, Science and Technology*  
*Departamenti i Shkencës dhe i Teknologjisë*

Departamenti i Arsimit të lartë dhe Shkencës dhe i Teknologjisë dhe Këshilli Shkencor i MASHT në vazhdim të aktivitetëve të tyre, bazuar në dispozitat e Ligjit për Veprimtari Kërkimore-Shkencore nr.04/L-135, bazuar në planin e veprimit të Programit Kombëtar të Shkencës në lidhje me përkrahjen e studimeve të doktoraturës në 500 universitetet më të mira në botë, shpall:

### KONKURS

**(Për ndarjen e 20 granteve ( bursave) të doktoraturës)**

Me të cilin ftohen studentët kosovarë që ndjekin studimet e doktoraturës në 500 universitetet më të mira në botë që të konkurrojnë për përfitim të një granti të doktoraturës. Konkursi është publik dhe vlen për studentët shtetas të Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh promovimin e barazisë gjinore, etnike, fetare dhe racore. Do të përkrahen studentët që nuk marrin bursë apo ndihmë financiare nga institucionet vendore apo ndërkombëtare, apo që në marrëveshje me institucionin ku punojnë (universitetin apo institutin) kanë marrëveshje për mungesë me pagesë për kohën e kryerjes së studimeve të doktoratës. Merren parasysh studentët që kanë përfutur ndonjë bursë apo lloj tjetër të financimit që mund të jetë i pjesshëm (që nuk i plotëson nevojat financiare për studime njëvjeçare sipas standardeve të vendeve ku është selia e universitetit). Studentët me bursa të plota nuk përkrahen. Për të konkurruar në konkurs, studentët e interesuar duhet t'i plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- CV (Biografia)
- Studenti të jetë shtetas i Republikës së Kosovës – dëshmi: letërnjoftimi ose pasaporta e Republikës së Kosovës.
- Studenti të vërtetohet se është student i rregullt (studenti duhet të dëshmojë se ka leje qëndrimi për kohën e studimeve në vendin mikpritës).
- Vërtetimi nga institucioni kosovar ku studentit është i punësuar, nëse studentit është lëshuar me pagesë për kryerjen e studimeve ose jo.
- Vërtetimi nga universiteti ku studentit i vijon studimet apo është regjistruar (studentët që kanë fituar të drejtën për studime por ende nuk i kanë regjistruar apo nuk i vijojnë ato, nuk përkrahen) në studimet e doktoraturës.
- Vërtetimi nga universiteti mikpritës se kandidati nuk ka bursë nga ky universitet apo nuk merr pagesë tjetër si pjesë e ndonjë projekti hulumtues në atë universitet dhe vërtetimin se kandidati nuk pranon ndonjë mbështetje financiare të natyrës tjetër nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor (studentët me bursa jo të plota apo me mbështetje jo të plotë financiare mund të mbështeten, në raste të veçanta).
- Një raport njëvjeçar të xhirologarisë së bankës në Kosovë dhe në vendin e studimeve.
- Studentët që nuk janë fillestarë duhet të sjellin dëshmi lidhur me provimet e dhëna apo dokumente origjinale që dëshmojnë arritjen e kushteve specifike që kërkon universiteti i veçantë për kryerjen me suksese të pjesës së kaluar të studimeve (provimet, pjesëmarrja në projekte hulumtuese shkencore, pjesëmarrja në konferenca, botime etj. Kjo vërtetohet me një dokument origjinal të nënshkruar dhe të vulosur nga autoritetet e universitetit).
- Deklaratën se studentit pas kryerjes së studimeve do të kthehet në Kosovë si dhe deklaratën nën betim, se studentit nuk merr bursë apo ndonjë ndihmë financiare tjetër.
- Një vërtetim zyrtar se universiteti është i ranguar ndër 500 më të mirët në botë.
- Përparësi kanë studentët që studiojnë në universitetet e ranguar më së larti në rangimet ndërkombëtare të universiteteve dhe fusha e studimeve të tyre bën pjesë në 5 plus 1, prioritetet kombëtare në bazë të Planit Kombëtar të Shkencës.
- Nuk mbështeten studentët që tashmë kanë përfunduar ciklin e ligjëratave apo që janë para mbrojtjes së disertacionit.
- Dokumentet relevante duhet të jenë të përkthyer nga një përkthyes zyrtar.

Do të merret parasysh rangimi i universiteteve nga **Lista e Shanghai** .

Konkursi mbetet i hapur (nga data 19.11.2019 deri më 03.12.2019) nga dita e shpalljes në gazeta, në ueb faqen e MASHT dhe mediat elektronike.

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në arkivin e MASHT.

Informatat shtesë mund të merren tek zyrtari kontaktues në MASHT znj. Yllza Memeti, në zyrën 302/ b. tel për kontakt : 038 211-867.

Aplikimi duhet të dorëzohet në një zarf të mbyllur ku të jetë shkruar “Aplikimi për grantet e doktoraturës” dhe në CD në adresën : Rr. “Agim Ramadani” p. n, 10000- Prishtinë, Kosovë.

**Aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë/ Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku i Tehnologiju/ Ministry of Education, Science and Technology*  
*Departamenti i Shkencës dhe i Teknologjisë*

Departament Visokog obrazovanja nauke i tehnologije i Naučnog saveta MONT-a u nizu svojih aktivnosti, na osnovu odredbi Zakona o Naučno istraživačkoj delatnosti br. 04/L-135, na osnovu plana delatnosti Nacionalnog naučenog programa u vezi podrške doktorskih studija na top 500 najboljih univerziteta u svetu objavljuje:

### KONKURS

**(Za dodelu 20 grante (stipendije) za doktorat)**

Pozivaju se kosovski studenti koji pohađaju doktorske studije na top 500 najbolja univerziteta u svetu da konkurišu za dobijanje grante za doktorat. Konkurs je javan i važi za studente državljanke Republike Kosova imajući u vidu promovisanje rodno, etničko, versku ili rasnu ravnopravnost. Biće podržani studenti koji ne primaju stipendiju ili finansijsku pomoć od domaćih ili međunarodnih institucija ili u sporazum sa institucijom u kojoj su zaposleni (univerzitet ili institut) ima sporazum za plaćenim odsustvom za vreme obavljanje doktorske studije. Biće uzeti u obzir studenti koji su dobili neku stipendiju ili drugu vrstu finansiranja koje može biti delimično (koje ne ispunjava jednogodišnje finansijske potrebe prema standardima zemlje u kojoj je sedište univerziteta). Studenti sa punom stipendijom neće biti podržani. Za konkurisanje na ovom konkursu, studenti treba da ispunjavaju sledeće posebne uslove:

- CV (Biografija)
- Student da je državljanin Republike Kosova – dokaz: lična karta ili pasoše Republike Kosova.
- Da je redovan student (ne na studije bez prekid radnog odnosa) i da dokaže da živi u zemlji u kojoj studira.
- Potvrda kosovskih institucija gde je student zaposlen, ako su studentu odobrene plaćene ili neplaćene studije.
- Potvrda sa univerziteta na kojem student pohađa studije ili je upisao (studenti koji su stekli pravo ali još uvek nisu upisali ili ne pohađaju, neće biti podržani) doktorske studije.
- Potvrda sa univerziteta domaćina da kandidat ne prima stipendiju ovog univerziteta ili ne dobija druga primanja kao deo nekog istraživačkog projekta na tom univerzitetu i potvrda da kandidat ne dobija neku finansijsku podršku druge prirode neke relevantne međunarodne ili domaće institucije (studenti sa polovičnom stipendijom ili nedovoljnom finansijskom podrškom mogu biti podržani, u posebnim slučajevima).
- Jednogodišnji finansijski izveštaj žiro računa iz banke na Kosovu i iz zemlje u kojoj studira.
- Studenti koji nisu početnici moraju dostaviti dokaz o položenim ispitima ili original dokumenta kojima se dokazuje postizanje specifičnih uslova koje zahteva poseban univerzitet za uspešan završetak prethodnog dela studije (ispiti, učešće u naučno istraživačkim projektima, učešće na konferencijama, objavljivanja itd. Ovo se potvrđuje originalnim dokumentom potpisanim i overenim od strane univerzitetskog autoriteta.)
- Izjava da će se student nakon završetka studije vratiti na Kosovo kao i Izjava pod zakletvom, da student ne prima stipendiju ili neku drugu finansijsku pomoć.
- Službena potvrda da je univerzitet rangirana na top 500 najboljih univerziteta.
- Prednost imaju studenti koji studiraju na univerzitetu najviše rangirane na međunarodnoj rang listi univerziteta, i njihova oblast studije je prisutan u 5 plus 1, nacionalni prioriteti na osnovu Nacionalnog naučnog plana.
- Neće biti podržani studenti koji su već završili ciklus predavanja ili koji su pred odbrane doktorske disertacije.
- Relevantna dokumenta treba da budu prevedena od strane službenog prevodioca.

**Biće uzeto u obzir rangiranje univerziteta na listi Shanghai**

**Konkurs je otvoren (od dana 19.11.2019.do 03.12.2019)** od dan objavljivanja u novinama, na web stranici MONT-a i elektronskim medijima.

Kompletirana dokumenta dostaviti u arhivi MONT-a.

Dodatne informacije možete dobiti od službenika za kontakte u MONT g. Yllza Mehmeti, u kancelariji 302/ b. Kontakt tel: 038 211-867.

Aplikaciju dostaviti u koverti zatvorenu na kojoj mora biti napisano “Aplikacija za grante za doktorat na adresi: Ul. “Agim Ramadani” b.b, 10000 Priština, Kosovo.

**Ne kompletirana dokumentacija neće biti uzeta na razmatranje.**



## NJOFTIM PËR SHUARJE TË BIZNESIT

Njoftojmë te gjithë klientët se "Ultra Computing Solutions and services - Prishtina" me seli ne Prishtine, ka marre vendim te shuaje biznesin me numër NUI. 810001264 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës se Likuidimit. Njoftohen te gjithë klientët qe kane raporte kreditore- debitorë qe te paraqiten ne afatin kohor pre 30 ditor nga data e shpalljes ne gazete.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Blerta Rusinovci shpallë të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore të mesme të ulët "Asim Vokshi" Prishtinë.
- ▶ Arxhend Ahmetaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmgj "Remzi Ademaj" Prizren
- ▶ Egzon Celavet shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.
- ▶ Aferdita Sylja shpall të pavlefshme diplomën e Bachelorit të Kolegjit FAMA Prishtinë, me nr. 450/1214.
- ▶ N.T.T. "VISARI" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70001337 si dhe me nr. unik 810321290.
- ▶ Zejdush Berisha shpalle te pavlefshme diplomën Kl 6-9 e Shkollës Fillore "Veli Ballazhi" Hani Elezit.
- ▶ Agnesa Cakolli nga Prishtina, shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Pavarësia" në Prishtinë.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtime i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.